



**Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë**  
**MISIONI NË KOSOVË**  
**Departamenti për të drejtat e njeriut dhe sundimin e së drejtës**

**STRUKTURAT PARALELE NË KOSOVË**

*tetor 2003*

## PËRMBAJTJA

### SHKURTIMET

SHKURTIMET .....4

HYRJE .....5

PËRMBLEDHJA EKZEKUTIVE .....6

REKOMANDIMET.....8

I. Zvogëlimi i kërkesës.....8

II. Zvogëlimi i mjeteve(shërbimeve) .....9

III. Masat për zbatimin e politikave .....9

*Kapitulli i parë*..... 11

STRUKTURAT PARALELE TË SIGURISË ..... 11

1.1 Hyrje – e kaluara historike.....12

1.2 Rojet e urës – gjendja e tanishme .....13

1.2.1 *Struktura organizative dhe financimi* .....13

1.2.2 *Aktivitetet* .....14

1.3 MPB-ja në veri të Mitrovicës/Mitrovica – gjendja e tanishme.....14

1.4 Inkorporimi i ish rojeve të urës dhe pjesëtarëve të MPB-së në Shërbimin Policor të Kosovës.....14

*Kapitulli i dytë* ..... 16

GJYKATAT PARALELE ..... 16

2.1 Historik.....17

2.2 Gjykatat ekzistuese.....17

2.2.1 *Rajoni i Mitrovicës/Mitrovica*.....17

2.2.2 *Prishtinë/Priştina* .....18

2.2.3 *Rajoni i Gjilanit/Gnjilane* .....19

2.2.4 *Rajonet e Pejës/Peç dhe Prizrenit* .....19

2.3 Efektet e sistemit të gjykatave paralele .....19

2.3.1 *Norma e punës* .....19

2.3.2 *Zbatimi* .....21

2.4 Analiza .....21

2.4.1 *Shqetësimet e tanishme*.....21

2.4.2 *Aktvendimet gjyqësore të kaluara të gjykatave paralele* .....22

2.4.3 *Rastet e pazgjidhura në gjykatat paralele* .....23

*Kapitulli i tretë*.....25

STRUKTURAT PARALELE ADMINISTRATIVE .....25

ÇËSHTJET PRONËSORO-JURIDIKE .....25

3.1 Historiku dhe çështjet .....26

3.2 Strukturat administrative paralele të vendosura në territorin e Kosovës .....27

3.2.1 *Drejtoratet komunale për urbanizëm* .....27

3.2.2 *Zyret kadastrale komunale* .....27

3.3 Zyret paralele kadastrale në Serbi.....27

3.4 Vlefshmëria ligjore e vendimeve të strukturave paralele administrative .....27

3.4.1 *Vlefshmëria ligjore e vendimeve të lëshuara nga strukturat administrative para themelimit të UNMIK-ut dhe ato të pranuar nga UNMIK-u dhe mungesa e mjeteve juridike* .....27

3.4.1.1 *Vlefshmëria juridike e vendimeve të marra nga organet para vendosjes së plotë të pushtetit të UNMIK-ut* .....28

3.4.1.2 *Vlefshmëria juridike e vendimeve të lëshuara nga strukturat administrative të pranuar nga UNMIK-u* .....28

3.4.1.3 *Hutia rreth mjeteve juridike*.....29

3.4.2 *Vlefshmëria ligjore e shënimeve kadastrale në Serbi*.....29

*Kapitulli i katërt*.....31

SHKOLLAT PARALELE .....31

4.1 Strukturat .....32

4.2 Shkaktarët dhe efektet e strukturave paralele.....33

<b>4.2.1 Shkaktarët kryesorë të strukturave paralele .....</b>	<b>33</b>
4.2.1.1 Perceptimi i mungesës së sigurisë .....	33
4.2.1.2 Qëndrimet e barrikaduara të një pjese të komunitetit të shqiptarëve të Kosovës dhe atij të serbëve të Kosovës kundrejt tolerancës dhe gjetjes së një baze të përbashkët .....	33
4.2.1.3 Pagat e dyfishta të ofruara për arsimtarët serbë .....	34
<b>4.2.2 Efektet e strukturave paralele.....</b>	<b>35</b>
4.2.2.1 Programet e ndryshme.....	35
4.2.2.2 Fëmijët janë zënë pengje në këtë betejë politike .....	35
<b>Kapitulli i pestë .....</b>	<b>37</b>
<b>SISTEMI SHËNDETËSOR PARALEL .....</b>	<b>37</b>
<b>5.1 Strukturat .....</b>	<b>38</b>
<b>5.2 Shkaqet dhe efektet e struktuarave .....</b>	<b>39</b>
<b>5.2.1 Shkaqet themelore të qendrave paralele të shëndetësisë .....</b>	<b>39</b>
4.2.1.1 Qëndrimet e barrikaduara të një pjese të komunitetit të shqiptarëve të Kosovës dhe atij të serbëve të Kosovës kundrejt tolerancës dhe gjetjes së një baze të përbashkët .....	39
4.2.1.2 Rrogat e dyfishta të paguara nga Ministria serbe e shëndetësisë.....	39
<b>5.2.2 Efektet e qendrave paralele të shëndetësisë .....</b>	<b>40</b>
<b>Kapitulli i gjashtë.....</b>	<b>41</b>
<b>MINISTRIA SERBE E PUNËVE TË BRENDËSHME .....</b>	<b>41</b>
<b>LËSHIMI I PATENTË SHOFERIT DHE DOKUMENTEVE TJERA.....</b>	<b>41</b>
<b>6.1 Strukturat .....</b>	<b>42</b>
<b>6.2 Efekti i strukturës .....</b>	<b>42</b>
<b>PËRFUNDIM .....</b>	<b>45</b>

## SHKURTIMET

QKK	Qendra Koordinuese për Kosovën
DD	Departamenti i Drejtësisë i UNMIK-ut
PDS	Partia Demokratike e Serbisë
RFJ	Republika Federative e Jugosllavisë
PZH	Personat e Zhvendosur
AKK	Agjencia Kadastrale e Kosovës
BKK	Buxheti i Konsoliduar i Kosovës
KFOR	Forca e Kosovës
UÇK	Ushtria Çlirimtare e Kosovës
LPK	Ligji Penal i Kosovës
SHPK	Shërbimi Policor i Kosovës
OKL	Oficeri për Komunitetin Lokal
KK	Kuvendi i Komunës
MASHT	Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë
OLK	Oficeri Ligjor Komunal
ZKK	Zyra Kadastrale Komunale
MPB	Ministria Serbe e Punëve të Brendshme (Ministarstvo Unutrašnjih Poslova)
NATO	Aleanca Veriatlantike
ZKJ	Zyra e Këshilltarit Juridik
ZPKK	Zyra për Kthimin dhe Komunitetet
OSBE	Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë
IPV	Institucionet e Përkohshme të Vetëqeverisjes
RSFJ	Republika Socialiste Federative e Jugosllavisë
MSAS	Ministria Serbe e Arsimit dhe Sportit
MSSH	Ministria Serbe e Shëndetësisë
KNS	Këshilli Nacional Serb
PSS	Partia Socialiste Serbe
PSSP	Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm
SPB	Sekretariati i Punëve të Brendshme (Sekretarijat Unutrašnjih Poslova)
UNHCR	Komesariati i Lartë i Kombeve të Bashkuara për Refugjatë
UNMIK	Administrata e Përkohshme e Kombeve të Bashkuara në Kosovë
KSKB	Këshilli i Sigurimit të Kombeve të Bashkuara

## HYRJE

Pas përfundimit të fushatës së bombardimeve të NATO-s në vitin 1999, serbët e Kosovës të cilër mbetën në Kosovë nuk e pranuan administratën e sapoformuar të UNMIK-ut. Për vite të tëra problemet e sigurisë shkaktuan vështirësi tek pjesëtarët e pakicës serbe dhe pakicave tjera që të udhëtojnë jashtë enklavave të tyre. Ata pjesëtarë të pakicave që jetonin në komunat e banuara me popullatë shumicë serbe në veri, shumë rrallë udhëtojnë nëpër pjesët tjera të Kosovës. Në këto enklava dhe në komunat veriore,<sup>1</sup> administrata serbe; gjyqet, shkollat, spitalet, etj i përgjigjeshin në mënyrë të drejtpërdrejt Beogradit, e cila praktikë vazhdon edhe më tutje. Pas përfundimit të konfliktit, u krijuan institucionet e reja, siç ishte forca serbe e cila kryente rolin e policisë në veriun e Mitrovicës/Mitrovica dhe Qendra koordinuese për Kosovën (QKK) me seli në Beograd.<sup>2</sup> UNMIK-u nuk i ka pranuar kurrë këto struktura të kontrolluara nga Serbia, të cilat veprojnë paralelisht me administratën e UNMIK-ut.

Në këtë raport, termi i përgjithshëm *strukturat paralele* përdoret për të definuar organet të cilat kanë funksionuar dhe vazhdojnë të funksionojnë në Kosovë edhe pas 10 qershorit 1999 dhe të cilat nuk e kanë mandatin për të vepruar në bazë të Rezolutës së Këshillit të Sigurimit 1244. Në shumicën e rasteve, këto institucione veprojnë *de facto* nën autoritetin e qeverisë serbe duke pasur juridiksion mbi territorin e Kosovës nga vetë Serbia, apo duke vepruar brenda territorit të Kosovës. Strukturat paralele në fjalë veprojnë në të njëjtën kohë dhe nën të njëjtën çati sikur edhe organet e pranuar nga UNMIK-u.<sup>3</sup>

Ekzistenca e sistemit të këtyre paralel, vazhdon të ketë ndikim substancial në shoqëri. Për të përgatitur një strategji me qëllim të adresimit të ekzistencës së strukturave të tilla paralele, UNMIK-u ka themeluar një grup punues i cili është i përbërë nga katër shtyllat, KFOR-i, zyra për kthim dhe komunitetet, zyra e këshilltarit juridik dhe akterë të tjerë. Grupi punues është takuar kohëve rishtazi me qëllim të përpilimit të një liste të strukturave paralele si një hap i parë drejt përgatitjes së një strategjie të mirëfilltë.

Ky raport ofron një pasqyrë të strukturave paralele ekzistuese në Kosovë. Raporti mbulon strukturat, gjykatat dhe strukturat administrative që punojnë kryesisht në çështje pronësore, shkollat, qendrat e kujdesit shëndetësor dhe dokumentet e lëshuara nga Ministria serbe e Punëve të Brendshme. Raporti në fjalë nuk mbulon të gjitha aktivitetet e qeverisë së Serbisë në territorin e Kosovës. Për shembull, aktivitetet e QKK-së të cilat për momentin janë duke u ndërmarrë me qëllim të sforcimit të strukturave administrative paralele nëpërmjet të emërimit të koordinatorëve dhe këshillave komunale, nuk është pjesë e këtij raporti. Në kuadër të rekomandimeve përkatëse, nuk është pasqyruar fakti se aktivitetet e strukturave të tilla paraqesin kërcënim serioz kundër autoritetit dhe efikasitetit të komunave dhe për këtë arsye kjo çështje duhet koordinuar nëpërmjet të PSSP-së.<sup>4</sup>

Qëllimi i këtij raporti është të përshkruhen dhe analizohen efektet e sistemeve paralele të cilat veprojnë në të njëjtin territor. Si rezultat i kësaj linden problemet të shumta. Në të drejtën penale problemet më serioze kanë të bëjnë me rrezikun e gjyqimit të dyfishtë për të njëjtën vepër penale (rrezikut të dyfishtë). Në të drejtën civile ende nevojitet të përcaktohet vlefshmëria e aktvendimeve gjyqësore të gjykatave paralele, për shembull në lëndët e

<sup>1</sup> Në rastet kur raporti në fjalë u referohet komunave veriore, nënkuptohet Leposavić/Leposaviqi, Zvečan/Zveçani, Zubin Potoku dhe pjesa veriore e komunës së Mitrovicës/Mitrovica (veriu i Mitrovicës).

<sup>2</sup> QKK-ja është themeluar në verën e vitit 2001 si rezultat i një vendimi të përbashkët të Qeverisë së Serbisë dhe Qeverisë së Republikës Federative të Jugosllavisë. Selia e QKK-së për momentin gjendet në Beograd dhe përbëhet nga nëntë sektorë, kryesisht sektori për kthimin, të dëbuarit, personat e zhvendosur dhe ndihmë humanitare, ruajtjen e trashëgimisë kulturore; një departament ligjor, administrata civile, sektori për rindërtim dhe zhvillim ekonomik, informim, departamenti për përcjellje dhe grupet tjera informative (fjala e QKK-së).

<sup>3</sup> Organet administrative të cilat janë përgjegjëse për çështjet pronësoro-juridike, të themeluara pas 10 qershorit 1999 nganjëherë pranojnë mandatin e UNMIK-ut mirëpo veprojnë *de facto* nën autoritetin e Beogradit.

<sup>4</sup> Lexo faqen e nëntë.

shkurorëzimit, pagesës së alimentacionit apo ndonjë kontesti civil. Fëmijët kosovar të cilët nuk ndjekin mësimet në kuadër të të njëjtit sistem për shkak se ekzistojnë dy sisteme arsimore me planprograme mësimore të ndryshme. Individët të cilët ngasin veturat me leje të vozitjes të lëshuara nga autoritetet serbe janë arrestuar dhe dënuar për posedim të dokumentit të rrejshëm.

Ky raport është i ndarë në gjashtë kapituj, ku secili prej tyre jep një pasqyrë mbi gjendjen e tanishme duke analizuar në të njëjtën kohë efektet që prodhojnë këto struktura paralele të veçanta. OSBE-ja ka bërë rekomandime të posaçme në lidhje me atë se si duhet përpjekur që të zgjidhen këto probleme, të cilat mund të gjinden pas përmbledhjes ekzekutive.

## PËRMBLEDHJA EKZEKUTIVE

OSBE ka shqyrtuar strukturat paralele në fushën e sigurisë, gjykatave, të drejtave pronësore, arsimit, kujdesit shëndetësor dhe lëshimit të dokumentacionit i cili ekziston në Kosovë. Qëllimi i këtij raporti është të vlerësohen aktvendimet dhe shërbimet të cilat i ofrojnë këto struktura dhe efektet e tyre në shoqëri.

Që nga qershori 1999, ekzistojnë dy subjekte kryesore të cilat shërbejnë si struktura paralele të sigurisë në veri të Mitrovicës/Mitrovica, të ashtuquajturit “rojet e urës” dhe policia e Ministrisë serbe të Punëve të Brendshme (*Ministarstvo Unutrasnih Poslova* – MUP). OSBE-ja edhe mëparë ka raportuar për aktivitetet e rojeve të urës, të cilët shërbenin si forcë policore në veri të Mitrovicës/Mitrovica dhe MPB-ja.<sup>5</sup> Rojet e urës filluan të humbin përkrahjen politike nga Beogradi dhe popullata vendëse në vitin 2002. Një përparim i dukshëm ishte shënuar sa i përket rekrutimit të policëve serbë të MPB-së, ku për momentin veprojnë 42 oficerë të SHPK-së të përkatësisë serbe në stacionin e policisë në veri të Mitrovicës/Mitrovica, prej të cilëve 19 janë ish pjesëtarë të MPB-së.

OSBE-ja ka raportuar edhe mëparë për sistemin e gjykatave paralele i cili vepron në rajonin e Mitrovicës/Mitrovica.<sup>6</sup> Që nga atëherë, UNMIK-u ka punuar mjaft drejt shpërbërjes së gjykatave paralele nëpërmjet hapjes së njëkohshme të gjykatave të UNMIK-ut në komunat veriore. Më 13 janar 2003, UNMIK-u hapi gjykatat komunale dhe për kundërvajtje në secilën nga komunat e banuara me popullatë shumicë serbe në Leposavić/Leposaviq dhe Zubin Potok, edhe pse ato ende nuk funksionojnë në mënyrë të plotë. Duket se ekzistojnë gjykata në Serbi të cilat kanë marrë përsipër juridikcionin mbi komunat dhe distriktet në Kosovë mirëpo të cilat veprojnë në Serbi. UNMIK-ut i nevojitet të kërkojë bashkëpunimin e Beogradit për t'i shpërbërë këto struktura. Për më tepër, UNMIK-u duhet të krijojë një mekanizëm i cili do të ketë mandatin për të përcaktuar vlefshmërinë juridike të aktvendimeve të prura nga gjykatat paralele.

Përderisa gjykatat paralele marrin përsipër juridikcionin mbi shumë raste pronësoro-juridike, ekzistojnë struktura paralele administrative të cilat bëjnë vendime në lidhje me të drejtat pronësore. OSBE-ja ka shqyrtuar shumë aktivitete të drejtorateve komunale për urbanizëm dhe zyreve komunale kadastrale në Kosovë, të cilat funksionojnë *de facto* nën autoritetin e Beogradit, sikurse edhe efektet e shënimeve kadastrale të bartura nga Kosova në Serbi.

Dy sisteme arsimore veprojnë në Kosovë pjesërisht për shkak të mungesës së besimit ndërmjet shqiptarëve dhe serbëve. Ky mosbesim manifestohet përmes refuzimit të sistemit arsimor të njëri tjetrit, për shkak të dëmit që mund ta shkaktojë tek fëmijët, si në aspektin e arsimimit që e marrin gjithashtu edhe kërcënimit të mundshëm për sigurinë e tyre personale. Të gjitha shkollat e vendosura qoftë në enklavat serbe apo edhe në komunat e banuara me popullatë shumicë serbe, shfrytëzojnë planprogramet mësimore të Ministrisë serbe të Arsimit dhe Sportit. Kjo ministri i'u siguron shkollave tekstet shkollore, diplomat dhe vulat. Mësimdhënësit dhe stafi ndihmës mbikëqyren në mënyrë të drejtpërdrejt nga Ministria serbe e Arsimit dhe Sportit, përderisa pagat i marrin edhe nga Ministria në fjalë mirëpo edhe nga IPV-të/Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë (MASHT). Sot shkollat e kontrolluara nga serbët nuk njohin diplomat e lëshuara nga shkollat kosovare dhe anasjelltas.

<sup>5</sup> Lexo raportin tematik të OSBE-së: Strukturat paralele të sigurisë në veri të Mitrovicës/Mitrovica, maj 2002.

<sup>6</sup> Lexo raportin tematik të OSBE-së: Aktivitetet paralele të gjykatave në veri të Mitrovicës/Mitrovica, maj 2002.

Në mes tjerash, ky mosbesim gjithashtu ka rezultuar në zhvillimin e sistemit paralel të kujdesit shëndetësor në Kosovë. Përpos sistemit shëndetësor të mbikëqyrur nga IPV-të, OSBE-ja ka identifikuar një numër të objekteve shëndetësore të cilat udhëhiqen nga Ministria serbe e Shëndetësisë (MSSH). MSSH-ja mbikëqyr dhe paguan pagat e stafit të punësuar dhe mbulon të gjitha shpenzimet tjera shtesë. Nuk ekziston ndonjë bashkëpunim ndërmjet dy sistemeve shëndetësore.

Ministria serbe e Punëve të Brendshme (MPB-ja) ka zyret e veta anembanë Kosovës. Aktivitetet e tyre kanë të bëjnë me administrimin e pasaportave, lejeve të vozitjes, letërnjoftimeve dhe tabelave të regjistrimit. Shumë kosovarë të përkatësive të ndryshme etnike janë mbështetur në shërbimet e ofruara nga këto zyre, sidomos ata të cilët duhet të udhëtojnë në serbi, për shkak se dokumentet e UNMIK-ut nuk trajtohen si të vlefshme atje. Problemet e ndryshme lindin kur këta individë përdorin këtë dokumentacion në Kosovë. Disa prej tyre janë arrestuar dhe dënuar për falsifikim, përderisa të tjerët janë gjobitur për posedim të dokumentacionit të pavlefshëm.

OSBE-ja e ka përpiluar një listë të rekomandimeve për UNMIK-un përkitazi me atë se si më së miri të adresohen këto çështje. Rekomandimet në fjalë janë paraqitur në vazhdim.



## REKOMANDIMET

UNMIK duhet të vendosë lidhur me politikat koherente që ndërlidhen me strukturat paralele në Kosovë. OSBE i përshëndetë nismat e UNMIK-ut për krijimin e grupeve punuese për shpërndarjen e strukturave paralele. Mirëpo, muk mund të merret me të gjitha ato në të njëjtën mënyrë. Problemet lidhur me sistemin e drejtësisë dhe sistemin policor janë përgjegjësi e drejtpërdrejtë e UNMIK-ut, ndërsa çështjet e arsimit dhe shëndetësisë duhet të trajtohen përmes ministrive përkatëse.

Shumica e çështjeve pasuese rekomandohet të jenë objekt i bisedimeve të pritura në mes të Prishtinës/Priştina dhe Beogradit, e posaçërisht ato të cilat sugjerojnë rritjen e nivelit të bashkëpunimit në mes ministrive korresponduese të resorit të shëndetësisë dhe arsimit.

Rekomandimet duhet të ndahen në tri kategori. Kategoria e parë e rekomandimeve ka aspirata të uljes së kërkesës për shërbime paralele, psh, të përmirësohen shërbimet e ofruara nga UNMIK-u dhe IPV-es dhe me këtë të fitojnë besueshmërinë e publikut. Kategoria e dytë e ulë nivelin e dhënjes së shërbimeve paralele përmes negociatave me ata që e stopojnë shkallën e shërbimeve. Kategoria e tretë e rekomandimeve synojnë imponimin e masave të caktuara të cilat mund të zbatohen. Të gjitha këto komponenta janë të domosdoshme për të reduktuar dhe eventualisht eliminuar vartësinë e disa komuniteteve në strukturat paralele të Kosovës. Disa rekomandime mund të vendosen në një ose më shumë kategori.

### I. Zvogëlimi i kërkesës

#### *Strukturat paralele të sigurisë*

- Për të zvogëluar në masë të konsiderueshme kërcënimin që shkaktohet nga strukturat paralele të sigurimit, policisë së UNMIK-ut dhe Shërbimit Policor të Kosovës (SHPK) duhet tu jipet përkrahje e mjaftueshme nga ana e administratës së UNMIK-ut dhe nga ana e politikanëve të Kosovës si në aspektin operacional të punës së tyer ashtu edhe lidur me aktivitetet e rekrutimit në veri të Mitrovicës /Mitrovica.
- Policia e UNMIK-ut dhe SHPK-ja duhet të zhvillojnë iniciativa policore më të fuqishme të bazuara në kontaktin me komunitet, në pjesën veriore të Mitrovicës/Mitrovica me qëllim të rritjes së besueshmërisë në polici dhe zhvillimit të bashkëpunimit në mes të policisë dhe popullatës lokale.

#### *Gjykatat paralele*

- Me qëllim të sfrocimit të besueshmërisë së publikut në gjykatat e UNMIK-ut, veçanërisht të komunave veriore, DD duhet të shqyrtojë nisjen e fushatave për vetësjësimin e publikut.

#### *Shkollat paralele*

- UNMIK-u/IPV-es duhet të bëjë analiza të thella lidhur me implikimet të cilat i ka sistemi paralel i shkollave në Kosovë. Dokumenti i përbashkët i cili parashikon që serbët e Kosovës duhet të kenë qasje të barabartë në arsim në gjuhën e tyre që nga shkolla fillore deri në nivelin universitar, dhe kjo duhet të implementohet nga UNMIK-u/IPV-es. UNMIK-u/IPV-es, duhet të mbulojnë me buxhet kushtet e shkollave në Kosovë të cilat i plotësojnë nevojat e popullatës serbe të Kosovës. Veçanërisht, librat dhe materiali tjetër shkollor duhet të sigurohet në gjuhën serbe.
- MASHT dhe MSAS duhet që menjëherë të hyjnë në negociata për planin e njohjes së ndërsjellë të diplomave dhe qertifikatave mbi mbarimin e shkollëve të ndryshme të arsimit dhe t'i standardizojnë kushtet për lëshimin e diplomave dhe qertifikatave.

#### *Shëndetësia paralele*

- UNMIK-u/IPV-es duhet të bëjnë analiza të thella lidhur me implikimet që mund t'i ketë sistemi paralel i shëndetësisë në Kosovë dhe të merr masa proaktive për të arritur deri te komunitetet e caktuara që t'ju ndihmojë atyre ta tejkalojnë frikën e kërkimit të ndihmës nga sistemi shëndetësor i UNMIK-ut.
- UNMIK-u/IPV-es duhet të arrijnë një marrëveshje të menjëhershme me Beogradin lidhur me sistemin nën të cilin sigurohet se pacientët dhe dosjet e tyre të mund të transferohen lehtë prej njërit sistem në tjetrin.<sup>7</sup>

## **II. Zvogëlimi i mjeteve(shërbimeve)**

#### *Gjykatat paralele*

- PSSP/UNMIK Shtylla I (për polici dhe drejtësi) duhet ta trajtojë çështjen e implementimit të deklaratës së përbashkët duke shiquar ka nevojë për një kujdesë më të madh kur është fjala për sigurinë, transportin dhe banimin e gjyqtarëve dhe prokurorëve serbë të Kosovës, për qëllim të inkurajimit të tyre që të punojnë në kuadër të gjyqësisë së UNMIK-ut.
- DD duhet të bëjë një analizë të numrit dhe natyrës së lëndëve të pazgjidhura në gjykatat paralele në mënyrë të që të krijojnë procedurë të transferimit në gjykatat e UNMIK-ut.

#### *Shkollat paralele*

- Në pajtim me dokumentin e përbashkët, duhet të arrihet një marrëveshje në mes të Beogradit dhe Prishtinës/Priştina, me qëllim të krijimit të një sistemi arsimor në Kosovë që është i pranueshëm për të gjitha komunitetet.

#### *Shëndetësia paralele*

- UNMIK-u/IPV-es duhet të hyjnë në marrëveshje me Beogradin, për qëllim të krijimit të një sistemi shëndetësor të konsoliduar në Kosovë i cili është i hapur për të gjitha komunitetet dhe përfundimisht të udhëhequr nga IPV-es.

#### *Ministria serbe e punëve të brendshme*

- UNMIK duhet të vazhdojë të inkurajojë qeverinë e Serbisë të nënshkruajë Protokollin lidhur me dokumentet e regjistrimit të automjeteve dhe lëvizjen e automjeteve të regjistruara dhe lëshimin e patentë shoferit, i cili do të krijojë një rregullativë të përbashkët të njohjes së tabelave të regjistrimit dhe dokumentacionit.

## **III. Masat për zbatimin e politikave**

#### *Gjykatat paralele*

- Preferohet të njihen vendimet e gjykatave paralele në komunat veriore prej datës 10 qershor 1999 dhe 13 janar 2003 (data e hapjes zyrtare të gjykatave të UNMIK-ut në Leposaviq/Leposavić dhe Zubin Potok). Kjo është e mundur vetëm nëse UNMIK-u e krijon një transparencë procedurale të rishqyrtimit. Deri në marrjen e vendimit, individët do të mbeten të pasigurtë lidhur me të drjetat dhe obligimet ligjore të tyre.

---

<sup>7</sup> Sipas Ministrisë së Shëndetësisë, ekziston një bashkëpunim minimal sa i përket transferimit të dosjeve, posaçërisht në rastet e aksidenteve të komunikacionit dhe situatave me kërcënim për jetë.

*Strukturat paralele administrative – çështjet pronësore*

- Preferohet që të njihen vendimet lidhur me pronën, të shqiptuara nga strukturat paralele administrative para se UNMIK-u të bëhet tërësisht funksional në komunat veriore. Njohja e tillë është e mundur vetëm nëse UNMIK-u krijon një transparencë procedurale të rishqyrtimit.
- PSSP-ja duhet ta bëjë të qartë çështjen e vlefshmërisë së aktvendimeve administrative mbi pronën të lëshuara nga strukturat paralele në Serbi.

*Ministria serbe e Punëve të Brendshme*

- UNMIK-u duhet të jetë eksplicit lidhur secilin nga aktivitetet e zyreve të SPB të cilat i konsideron legjitime.
- UNMIK-u duhet të jetë më i zellshëm lidhur me informimin e opinionit publik mbi statusin dhe ligjshmërinë e dokumenteve të FRJ/Serbisë si dhe afatin kohor të aplikimit për tabela të UNMIK-ut. Nga ky aspekt, zyra e PSSP-së duhet të sigurojë që vendimet ekzekutive të bëhen publike.

*Kapitulli i parë*

**STRUKTURAT PARALELE TË SIGURISË**

### 1.1 Hyrje – e kaluara historike<sup>8</sup>

Dy subjektet kryesore të cilat janë të përfshira në strukturat paralele të sigurisë në Mitrovicën/Mitrovica veriore që nga qershorit 1999 janë të ashtuquajturit rojet e urës<sup>9</sup> dhe Ministria serbe e Punëve të Brendshme (*Ministarstvo Unutrasnih Poslova* – MUP).

Pas përfundimit të konfliktit në vitin 1999, disa serbë të Kosovës mbledheshin rregullisht në disa pika kalimi të urës mbi lumin Ibër me qëllim që t'i parandalonin shqiptarët e Kosovës që të ktheheshin në Mitrovicën Veriore. Në fillim këta persona mbledheshin spontanisht afër urës pa udhëheqësi dhe pajisje, mirëpo më vonë filluan të organizohen gjithnjë e më shumë. Rojet e urës e konsideronin vetën si një organizatë të sigurisë me tri funksione kryesore: t'i parandalojnë shqiptarët e Kosovës që të kthehen në veriun e Mitrovicës/Mitrovica; të mbledhin informata për KFOR-in dhe policinë e UNMIK-ut; dhe të mbledhin informata për ata shqiptarë të Kosovës të cilët jetonin në veri të qytetit. Kah fundi i vitit 1999, rojet e urës u bënë një strukturë e organizuar, e cila i koordinonte aktivitetet e tyre nëpërmjet të radio operatorëve dhe pajisjeve tjera komunikuese. Anëtarët e saj punonin në ndërrime dhe atyre gjithashtu u paguheshin edhe pagat.<sup>10</sup> Gjatë kësaj kohe u themelua edhe një organizatë e quajtur Shoqata e qytetarëve të urës Shën Demetrini (OJQ serbe). Themelimi i kësaj organizate ishte përpjekje për të krijuar një front për organizatën e rojeve të urës, sidomos për t'i ndihmuar në realizimin e qëllimeve të saj politike.

Që nga fundi i vitit 1999 deri në 2001, policia e UNMIK-ut (e cila në përgjithësi konsiderohej nga ana e komunitetit lokal në Mitrovicën veriore si forcë okupuese) ishte e përfshirë në konflikte të rregullta me popullatën civile, e cila gjë kufizonte aftësinë e tyre për t'i kryer aktivitetet e tyre policore në mënyrë të rregullt. Rojet e urës dhe MPB-ja filluan të mbushin vakumin e krijuar. Në mungesë të një force efektive policore të UNMIK-ut në veri të Mitrovicës/Mitrovica, rojet e urës (dhe në një masë më të vogël edhe MPB-ja) u bënë “organi kryesor për zbatimin e ligjit”.<sup>11</sup>

Pas korrikut 2000, filluan të ndodhin përplasje të thella politike në mesin e rojeve të urës, e cila gjë rezultoi në krijimin e fraksioneve të ndryshme në kuadër të këtij grupi dhe të luftës për pushtet në kuadër të kësaj strukture.

Nga mesi i vitit 2002, rojet e urës filluan të humbin mbështetjen e Beogradit dhe të popullatës lokale.<sup>12</sup> Në mungesë të financimit adekuat dhe mbështetjes nga ana e popullit, një strukturë e unifikuar organizative dhe politike si rojet e urës filluan të vërehen më pak dhe dukej të kishin qenë jo aktiv për disa muaj. Gjatë kësaj kohe pjesëtarët e rojeve të urës kanë qenë të përfshirë në incidentet e ndryshme të cilat destabilizonin gjendjen e sigurisë në veri të

<sup>8</sup> Në maj 2002, OSBE-ja lëshoi një raport tematik mbi strukturat paralele të sigurisë në Mitrovicën Veriore/Mitrovica (raporti i vitit 2002). Raporti 2002 përpos që bënte fjalë për zhvillimin historik të këtyre strukturave ajo gjithashtu ofronte informata edhe për efektin e këtyre strukturave në vendosjen e sundimit të së drejtës dhe jepte rekomandime për veprimet përkatëse që duhet ndërmarrë me qëllim të adresimit të kësaj çështje. Raporti i tanishëm ka për qëllim të ofrojë risi në krahasim me raportin 2002, edhe pse disa përshkrime historike që përmbaheshin në raportin 2002 përsëriten edhe në këtë raport.

<sup>9</sup> UNMIK-u ka kërkuar që rojet e urës duhet thirrur “banda e urës” me qëllim që të mos legjitimojmë ekzistencën e tyre. Për shkak se ky raport i referohet ngjarjeve që kanë ndodhur në të kaluar (në kohën kur grupi njihej me emrin rojet e urës) OSBE-ja ende i referohet këtij grupi me atë emër.

<sup>10</sup> Rojet e urës paguheshin si nga donacionet vullnetare ashtu edhe nga buxheti i spitalit në veri të Mitrovicës/Mitrovica (i cili është nën autoritetin e Ministrisë serbe të Shëndetësisë).

<sup>11</sup> Rojet e urës njihen si organizatë e cila i ka arrestuar njerëzit dhe i'u ka dorëzuar autoriteteve në Serbi për gjykim.

<sup>12</sup> Si duket Beogradi pushoi të mbështet politikisht rojet e urës pjesërisht për shkak të vendimit të Këshillit nacional serb për të bojkotuar zgjedhjet komunale. Këshilli nacional serb është një lëvizje e cila është krijuar në Kosovë pak para fillimit të fushatës së bombardimeve të NATO-s. KNS-ja, në atë kohë ishte kundër partisë socialiste në pushtet duke kërkuar që të tejkalohen të gjithë kufijtë politik për t'i mbrojtur interesat serbe në Kosovë. KNS-ja ishte e shoqëruar me rojet e urës nëpërmjet të udhëheqësit të KNS-së në atë kohë, i cili i ofronte mbështetjen politike për rojet e urës.

Mitrovicës/Mitrovica,<sup>13</sup> mirëpo incidentet e tilla nuk duket se ishin të koordinuara nga rojet e urës si një grup i organizuar. Sidoqoftë, pas një periudhe relativisht të qetë, më 2 gusht 2003 përafërsisht 30 shqiptarë të Kosovës u mblodhën në pjesën veriore të urës dhe filluan të fjaloseshin me katër serbë të Kosovës. Pas disa minutave afro 150 serbë të Kosovës u mblodhën në pjesën veriore në afërsi të urës. Ura u mbyll për një kohë derisa situata nuk u qetësua. Ky incident demonstroi se serbët e Kosovës në Mitrovicë/Mitrovica janë ende syhapur dhe ende të organizuar mirë për t'u tubuar në numër më të madh sipas nevojës. Mbetet të shihet se a paraqet kjo një riorganizim të Rojeve të Urës në veri të Mitrovicës/Mitrovica.

Sa i përket pranisë së oficerëve të MPB-së, MPB-ja e cila vepron në veri të Kosovës gjithmonë është përpjekur të veprojë e pavërejtur dhe roli i tyre kur nuk ka qenë i qartë. Në të kaluarën, oficerët e MPB-së në veri të Kosovës kanë vepruar edhe më shumë të pavërejtur. Disa pjesëtarë të MPB-së madje janë bërë pjesëtarë të Shërbimit Policor të Kosovës (SHPK).

Pjesa në vijim bën fjalë për organizimin e tanishëm dhe aktivitetet e strukturave të sigurisë që nuk i takojnë UNMIK-ut në komunat veriore të Kosovës.

## 1.2 Rojet e urës – gjendja e tanishme

### 1.2.1 Struktura organizative dhe financimi

Që nga maji 2002, struktura organizative, aktivitetet vepruese dhe numri i rojeve të urës ka ndryshuar në masë të madhe.<sup>14</sup>

Duket se autoritetet serbe kanë pushuar t'i paguajnë strukturat e rojeve të urës që nga janari 2003.<sup>15</sup> Sipas fjalëve të një anëtarit të Bordit këshilldhënës,<sup>16</sup> më shumë se gjysma e ish pjesëtarëve të rojeve të urës për momentin janë të papunësuar dhe kërkojnë ndihmë financiare. Është e paqartë se nga kush këta pjesëtarë pranojnë ndihmë financiare e cila mbledhet nga pronarët e lokaleve dhe bizneseve të ndryshme. Sipas të njëjtit burim, e mbështetur edhe nga një burim tjetër vendës, ky lloj i financimit ka pushuar së ekzistuari.

Përafërsisht 20-30 pjesëtarë të mbetur të grupit punojnë në kuadër të stafit të sigurisë në spitalin e Mitrovicës veriore. Ekzistojnë gjithashtu pjesëtarë tjerë të këtij grupi të cilët janë pjesë e listës së pagave por nuk paraqiten në punë. As policia e UNMIK-ut, as KFOR-i e as Ministria e Shëndetësisë e Kosovës nuk kanë kontroll mbi këtë objekt dhe aktivitetet e tij.<sup>17</sup>

Krahas kësaj, burimet vendëse theksojnë se resurs shtesë i mbështetjes financiare për rojet e urës mund të jetë ndihma humanitare e cila i jipet Shoqatës së qytetarëve të Shën Demetrinit

<sup>13</sup> Më 8 maj 2003, një grup i 50 serbëve të Kosovës dhe 10 shqiptarëve filluan të provokojnë njëri tjetrin nga të dyja anët e urës kryesore. KFOR-i intervenoi dhe qetësoi situatën mëpastaj. Më 30 maj 2003, për shkak të tollovisë në trafik të shkaktuar në zonën e quajtur "Bosna e vogël" si rezultat i një kamioni i cili i përkiste një OJQ-je ndërkombëtare nga i cili shkarkohej material ndërtimor për rindërtim, një ngasës serb i veturës u bë agresiv dhe sulmoi një pjesëtar të policisë së UNMIK-ut. Si rezultat i kësaj polici e arrestoi ngasësin e veturës. Pas arrestimit në vendin e ngjarjes u mblodh një grup i serbëve të cilët filluan të hedhin gurë mbi policët dhe punëtorët shqiptarë. Tri policë dhe një shqiptar pësuan lëndime të lehta përderisa dritaret e kamionit gjithashtu u thyen si rezultat i këtij incidenti.

<sup>14</sup> Për organizatën para majit 2002, lexo Raportin tematik të OSBE-së: Strukturat paralele të sigurisë në Mitrovicën veriore, maj 2002, faqe 4.

<sup>15</sup> Pushimi i financimit i përgjigjej pushimit të dhënies së mbështetjes politike për të cilën bëhet fjalë në fusnotën nëntë si mëlartë. Ajo gjithashtu koïncidonte me siç thuhet "marrëveshjen" për t'i rekrutuar ish pjesëtarët e rojeve të urës dhe oficerët e MPB-së në SHPK.

<sup>16</sup> Në Mitrovicën veriore/Mitrovica, UNMIK-u ka themeluar një Bord këshilldhënës tetëanëtarësh, i cili ka për qëllim t'i komunikojë shqetësimet e banorëve të veriut të Mitrovicës administratës së UNMIK-ut.

<sup>17</sup> OSBE-ja posedon me informata se ekzistojnë më shumë persona të cilët gjenden në listën e pagave në spitalin e Mitrovicës veriore sesa që ka të punësuar në këtë institucion. Lexo kapitullin e pestë, kujdesi shëndetësor paralel, faqe 36-37.

nga ana e autoriteteve të Beogradit. Sidoqoftë, policia e UNMIK-ut beson se ky financim bëhet në përmasa të vogla dhe për momentin ka pushuar së ekzistuari.

### 1.2.2 Aktivitetet

Në përgjithësi, një grup i përbërë prej 50-80 ish pjesëtarëve të Rojeve të Urës nuk i përgjigjen më ankesave penale dhe nuk ndërmarrin kurfarë aktiviteti policor. Disa lokacione të caktuara në veri të qytetit ende frekuentohen nga grupe të ish pjesëtarëve të rojeve të urës, edhe pse ata nuk kanë ndonjë ndikim të madh. Për shembull për momentin nuk ekziston ndonjë prani e rojeve të urës në urën kryesore që ndan veriun nga jugu i Mitrovicës/Mitrovica. Në bazë të policisë së UNMIK-ut, mbetet e këtij grupi mund të përpiqen të përfitojnë nga incidentet e sigurisë me qëllim që të fitojnë kapital politik dhe personal.<sup>18</sup>

### 1.3 MPB-ja në veri të Mitrovicës/Mitrovica – gjendja e tanishme

Oficerët e MPB-së janë të organizuar mirë dhe vazhdojnë t'i mbajnë zyret e tyre në Zvečan/Zveçan, Zubin Potok dhe veri të Mitrovicës/Mitrovica. Ata mbajnë profilin e tyre të ulët, mirëpo ende vazhdojnë të kryejnë detyra administrative siç është procesimi i kërkesave për pasaportë dhe leje të vozitjes. Siç duket këta oficerë të MPB-së nuk janë duke bartur më të dyshuar për në kufirin administrativ Kosovë-Serbi me qëllim që t'ua dorëzoje policisë.

### 1.4 Inkorporimi i ish rojeve të urës dhe pjesëtarëve të MPB-së në Shërbimin Policor të Kosovës<sup>19</sup>

Një përparim i duhur është shënuar në rekrutimin e oficerëve të MPB-së serbe në Shërbimin Policor të Kosovës që nga maji 2002 kur OSBE-ja kishte publikuar raportin e saj të fundit mbi strukturat paralele të sigurisë në pjesën veriore të Mitrovicës/Mitrovica.<sup>20</sup> Në çerekun e dytë të vitit 2002, shumë ish pjesëtarë të rojeve të urës filluan t'i dorëzojnë kërkesat për t'u bërë pjesëtar i SHPK-së.<sup>21</sup> Sidoqoftë, vetëm tri kërkesa ishin të suksesshme. Disa pjesëtar të rojeve të urës më vonë pohuan se procesi i përzgjedhjes ishte i anshëm dhe i padrejtë.

Në bazë të Shkollës së Shërbimit Policor të Kosovës (SHSHPK), procesi i përzgjedhjes për këtë grup të oficerëve të ardhshëm të SHPK-së ishte i ndryshëm nga procesi i zakonshëm i përzgjedhjes për shkak të natyrës së këtij grupi. Qëllimi i këtij rekrutimi ishte që të inkorporohen personat me përvojë dhe ndikim në strukturat serbe të sigurisë në SHPK ashtu që serbët të fillojnë të fitojnë më shumë besim në SHPK-në (e cila kah fundi i vitit 1999 ishte e përbërë nga 45 % ish pjesëtarët e UÇK-së). Autoritetet e Beogradit e aprovuan këtë proces. Listat e kandidatëve përpiloheshin nga agjencitë e ndryshme jashtë SHPK-së. Personat, kërkesat e të cilëve ishin refuzuar nga zyra e rekrutimit të SHPK-së ishin ata që ishin nën standardin minimal profesional i cili kërkohej. Kriteri i shfrytëzuar për të zgjedhur kadetët përfshijnë moshën, arsimimin, vendbanimin, ekzaminimin fizik dhe psikik dhe kontrollimin e historikut të atij personi.

<sup>18</sup> Lexo hyrjen për incidentet të cilat kanë ndodhur kohëve të fundit. Duhet gjithashtu të vërehet se më 14 gusht 2003, gjatë një seance të jashtëzakonshme, Kuvendi Komunal në Zvečan/Zveçan morri vendim të mbledh një "komitet për vetëmbrojtje nga sulmet e terroristëve dhe ekstremistëve shqiptar." Detyra e këtij komiteti, thuhet të jetë "ndërmarrja e veprimeve politike, këshilldhënëse, organizative dhe masave tjera për mbrojtjen e popullatës serbe në komunën e Zveçanit dhe më gjerë, përfshirë këtu edhe institucionet ndërkombëtare dhe organat qeveritare të Serbisë dhe Malit të Zi dhe Republikës së Serbisë, sikurse edhe masat për vetëmbrojtjen e qytetarëve në komunën e Zveçanit në rast se institucionet e lartpërmendura dështojnë të ofrojnë siguri për këta njerëz." (Vendimi 01 Nr. 016-1/-03)

<sup>19</sup> Dokumenti i përbashkët i UNMIK-ut dhe RFJ-së i 5 tororit 2001 përsërit në mënyrë të fuqishme zotimin e dhënë për të zhvilluar dhe forcuar Shërbimin Policor të Kosovës ashtu që të gjitha komunitetet të kenë besim në një forcë policore profesionale, multietnike dhe gjithëpërfshirëse e cila ka për qëllim të vetëm t'i shërbejë dhe mbrojtë të drejtat e të gjithë njerëzve në Kosovë, përdërisa duhet të vazhdohet me zotimin për t'i dhënë më shumë prioritet rekrutimit të më shumë serbëve të Kosovës në Shërbimin Policor të Kosovës, sidomos të atyre nga veriu i Kosovës.

<sup>20</sup> Lexo fusnotën shtatë.

<sup>21</sup> Sipas policisë së UNMIK-ut në rajonin e Mitrovicës/Mitrovica region, grupi i parë i aplikantëve serbë të cilët ishin pranuar për testim fillestar përbëheshin nga 120 ish pjesëtarë të MPB-së dhe rojeve të urës. Grupi i dytë përbëhej nga përafërsisht 70 persona (të profesioneve të ndryshme).

Në dritën e papunësisë së vazhdueshme që mbretëron në veri të Mitrovicës/Mitrovica, ish pjesëtarët e Rojeve të Urës thuhet të kenë shprehur dëshirë t'i nënshtrohen procesit të përzgjedhjes me qëllim që të anëtarësohen në SHPK.<sup>22</sup>

Në bazë të Koordinatorit Regjional të SHPK-së në Mitrovicë/Mitrovica janë gjithsejt 42 oficerë të SHPK-së të përkatësisë serbe, 19 prej të cilëve janë ish pjesëtarë të MPB-së dhe të cilët shërbejnë në stacionin policor në veri të qytetit. Tetë prej tyre të cilët shërbejnë në stacionin policor në Leposavić/Leposaviq police janë ish pjesëtarë të MPB-së. Sidoqoftë, më 29 maj 2003, katër pjesëtarë të SHPK-së të cilët kishin qenë ish pjesëtarë të MPB-së dhanë dorëheqje nga funksionet e tyre si polic në Mitrovicë/Mitrovica. Sipas policisë përbindja e dorëheqjeve nuk është e pazakonshme nëse marrim parasysh të gjithë faktorët praktik që ndikojnë në karrierën e një polici (siç janë të drejtat në pension e cila ofrohet nga Ministria serbe e Punëve të Brendshme, dhe pagat e ulëta të cilat ofrohen për pjesëtarët e SHPK-së).<sup>23</sup>

---

<sup>22</sup> Nuk ekzistojnë shënime të gatshme statistikore se si këta pjesëtarë të rojeve të urës apo ish pjesëtarë të MPB-së kanë aplikuar në SHPK. Shënimet në dispozicion janë gjithashtu hutuese për shkak se si aplikantët serbë gjithashtu edhe ata shqiptarë kanë pasur përvojë paraprake ushtarake apo policore në kuadër të ish regjimit jugosllav. Ata shqiptarë të Kosovës me përvojë policore që janë mbi moshën 35 vjeçare mund të kenë qenë pjesëtarë të MPB-së.

<sup>23</sup> OSBE-ja është informuar se dorëheqjet në fjalë ishin të motivuara nga frustrimi në SHPK-në për shkak se kjo e fundit nuk ka rekrutuar numrin e duhur të ish pjesëtarëve të MPB-së. Sipas SHPK-së, dorëheqjet ishin të shtyera edhe nga kundërshtimi i policisë së UNMIK-ut për të zbatuar rregulloret mbi regjistrimin e automjeteve dhe lejeve të vozitjes (për më shumë informata për çështjen e lejeve të vozitjes, lexo kapitullin e gjashtë, Ministria serbe e Punëve të Brendshme, faqe 39).



*Kapitulli i dytë*

**GJYKATAT PARALELE**

## 2.1 Historik

Në maj 2002, OSBE-ja raportoi për ekzistencën e gjykatave të udhëhequra nga serbët të cilat vepronin në rajonin e Mitrovicës/Mitrovica, jashtë strukturave administrative të UNMIK-ut.<sup>24</sup> Në atë kohë OSBE-ja gjithashtu raportoi për funksionimin e gjykatave për kundërvajtje dhe/apo komunale në Mitrovicë/Mitrovica, Leposavić/Leposaviq, Zubin Potok dhe Zvečan/Zveçan. Sipas shënimeve të pranuar në atë kohë, ishin gjithsej 34 gjyqtarë të cilët punonin në strukturat paralele të gjykatave. Gjykata e Qarkut për këto gjykata komunale ishte e vendosur në Kraljevë, Serbi.<sup>25</sup> OSBE-ja gjithashtu në të kaluarën ka raportuar për ekzistimin e gjykatave serbe që veprojnë jashtë territorit të Kosovës, të cilat pohojnë se kanë jurisdikcion në Kosovë.<sup>26</sup>

Sipas informatave të OSBE-së duket se ekzistojnë gjykatat në Serbi të cilat e mbulojnë çdo komunë dhe qark të Kosovës. Shumica e këtyre gjykatave janë të vendosura në Serbi. Me fjalë të tjera, pas përfundimit të konfliktit në vitin 1999 këto gjykata u tërheqën në Serbi, mirëpo ato ende pohojnë se kanë jurisdikcion në territorin e Kosovës.

UNMIK-u ka punuar mjaft në shpërndarjen e gjykatave paralele nëpërmjet të hapjes së gjykatave të UNMIK-ut në komunat veriore. Në këtë kontekst, më 9 korrik 2002, u nënshkrua një Deklaratë e Përbashkët<sup>27</sup> ndërmjet të ministrit të Drejtësisë së Republikës së Serbisë dhe zëvendësit të PSSP-së për Polici dhe Drejtësi, me qëllim të lehtësimit të rekrutimit të gjyqtarëve dhe prokurorëve serbë në sistemin e gjykatave të UNMIK-ut. Pas procesit të aplikimit, më 13 janar 2003, UNMIK-u themeloi gjykatat për kundërvajtje dhe komunale në të gjitha komunat me popullsi shumicë serbe siç janë Leposavić/Leposaviq dhe Zubin Potoku. Katër gjyqtarë të gjykatës komunale dhe tre të gjykatës kundërvajtëse të përkatësisë etnike serbe e kanë dhënë betimin pranë PSSP-së të emëruar me 13 janar 2003. Shumica e gjyqtarëve por edhe personelit teknik, më heret kanë punuar në sistemin paralel, ndërsa gjykatat e rithemeluara janë hapur në ndërtesat e gjykatave paralele, duke nënkuptuar me këtë shpërndarjen e gjykatave paralele. Janë hapur edhe gjykata për kundërvajtje dega e gjykatës komuale të Ferizajit/Urosevac në Shtërpçë/Štrpce. Njëri gjyqtar është emëruar për të punojë në gjykatën kundërvajtëse në Shtërpçë/Štrpce ndërsa tre kandidatë aktualisht janë duke u shqyrtuar nga Kuvendi i Kosovës për punën në gjykata komunale dhe për kundërvajtje. Gjykatat rishtazi të themeluara nga UNMIK-u ende nuk janë tërësisht funksionale.

## 2.2 Gjykatat ekzistuese

### 2.2.1 Rajoni i Mitrovicës/Mitrovica

Përkundër themelimit të gjykatave të UNMIK-ut në Leposavić/Leposaviq dhe Zubin Potok, gjykatat paralele ende funksionojnë në mënyrë aktive. Gjykata komunale paralele në Mitrovicë/Mitrovica, gjykata për kundërvajtje në Zvečan/Zveçan, dhe një zyre e gjykatës komunale të Mitrovicës/Mitrovica të vendosura në Zubin Potok edhe sot e kësaj dite funksionojnë. Gjithashtu ekziston edhe zyra paralele e prokurorit publik të qarkut të Mitrovicës/Mitrovica, i cili operon në Zveçan/Zveçan me së paku dy prokurorë të angazhuar.

Në mars 2003, OSBE-ja u takua me kryetarin e gjykatës komunale paralele të Mitrovicës/Mitrovica në Zvečan/Zveçan, sikurse edhe me kryetarin dhe tre gjykatës tjerë nga gjykata paralele në Mitrovicë/Mitrovica të cilat janë zhvendosur në Kraljevë, Serbi. Kryetari i Gjykatës së Qarkut ka deklaruar se gjykatat serbe të vendosura në komunat veriore të Kosovës janë ende të lidhura me Ministrinë serbe të Drejtësisë në Beograd. Ai deklaroi se

<sup>24</sup> Lexo raportin tematik të OSBE-së mbi aktivitetet e gjykatave paralele në veri të Mitrovicës, 13 maj 2002, faqe 2.

<sup>25</sup> Id.

<sup>26</sup> Lexo Vlerësimin e nëntë të OSBE-së dhe UNHCR-së mbi gjendjen e pakicave etnike në Kosovë, maj 2002, faqe 17.

<sup>27</sup> “Deklarata e përbashkët mbi rekrutimin e gjyqtarëve dhe prokurorëve të përkatësisë etnike serbe në sistemin shumetnik të judikaturës në Kosovë”.

gjykatat nuk i përdorin vetëm serbët mirëpo edhe shqiptarët të cilët kanë nevojë të marrin dokumente serbe të udhëtimit. Ai vërtetoi se selia e gjykatës serbe të qarkut të Mitrovicës gjendet në Krajlevë.

Gjykata paralele komunale e Mitrovicës/Mitrovica gjithashtu është duke vepruar në kuadër të një nëndege të saj në Zubin Potok. Kjo zyre është e vendosur në ndërtesën e komunës së Zubin Potokut në të njëjtin kat sikurse edhe zyret e gjykatave të UNMIK-ut. Në derë të zyrës gjendet mbishkrimi: “Vërtetimi i kontratave, autorizimeve; prej të martës deri të premten 9 – 11 am; Gjykata Komunale e Mitrovicës nëndege në Zubin Potok.” OSBE-ja e vizitoi këtë zyre dhe u takua me dy persona nga kjo zyre. Këta persona vërtetuan se kjo zyre vepron në kuadër të sistemit serb të gjykatave dhe se është degë e gjykatave në Kosovska Mitrovica.” Këta individë gjithashtu pohuan se ata nuk janë të autorizuar për të dhënë ndonjë deklaratë tjetër; se vetëm kryetari i gjykatës mund të jap deklaratat zyrtare. Mirëpo ata deklaruan se do t’i lëshojnë zyret vetëm nëse pranojnë kërkesë me shkrim nga Ministria serbe e Drejtësisë.

Krahas gjykatave paralele komunale në Mitrovicë/Mitrovica, ekziston edhe një gjykatë për kundërvajtje në Zvečan/Zveçan. Sipas informatave me të cilat posedon OSBE-ja, gjykata shumë rrallë i dëgjon rastet për shkak se policia e Serbisë nuk ka mundësi të patrullojë nëpër rrugët e këtij qyteti.<sup>28</sup> Më 6 shkurt 2003, u mbajt një mbledhje ndërmjet të përfaqësuesve të UNMIK-ut dhe gjykatës paralele për kundërvajtje të vendosur në Zvečan/Zveçan. Mbledhja u thirr me kërkesë të stafit të gjykatës, me qëllim të inicimit të një propozimi për hapjen e një gjykate për kundërvajtje nën autoritetin e UNMIK-ut në Zvečan/Zveçan. Në këtë mbledhje kryetari shprehi gatishmërinë për të aplikuar për atë funksion. Propozimi ishte refuzuar nga Kuvendi Komunal më 11 korrik 2003.

OSBE-ja është informuar se kryetari i mëparshëm i gjykatës komunale të Leposaviqit/Leposavić, para pak kohe ishte përpjekur ta rihapë gjykatën komunale paralele. Një sekretar dhe një bashkëpunëtor profesional nga gjykata komunale e sapo hapur nga UNMIK-u në Leposavić/Leposaviq dhanë dorëheqje pas lajmit për rihapjen e gjykatës komunale paralele e cila i punësoi menjëherë ata. Megjithatë, përpjekja për të rihapur gjykatën komunale paralele ishte parandaluar pas intervenimit të DD-së dhe zyrtarit ligjor të komunës së Leposaviqit/Leposavic.

### **2.2.2 Prishtinë/Priştina**

OSBE-ja ka dijeni se një gjykatë paralele komunale është duke vepruar brenda territorit të Prishtinës/Priştina: ajo është gjykata komunale e vendosur në fshatin Lepina/Lepinë të komunës së Lipjanit/Lipljan. Më 5 maj 2003, OSBE-ja u takua me një gjyqtar serb të Kosovës i cili udhëheq me punën e gjykatës. Sipas këtij gjyqtari, gjykata në fjalë ka jurisdikcion mbi territorin e komunës së Lipjanit/Lipljan. Kjo gjykatë përpunon një mesatare prej 20 lëndëve në muaj. Shumica e këtyre rasteve janë lëndë pronëso- juridike apo të trashëgimisë.<sup>29</sup> Gjykatësi në fjalë shpjegoi se serbët e Kosovës shpeshherë ishin të shtyer që të mbështeten në punën e gjykatave paralele për shkak se qeveria e Serbisë nuk pranon vendimet e UNMIK-ut. Për shembull, nëse një lëndë ka të bëjë me kërkesën për para nga qeveria e Serbisë, është më efikase të parashtrahet kërkesë pranë gjykatës serbe. Gjykatësi në fjalë gjithashtu përmendi tri raste kur gjithashtu edhe shqiptarët e Kosovës kishin kërkuar ndihmën e gjykatës serbe për shkak të arsyeve të lartëpërmendura dhe se ankesat kundër vendimit të gjykatës në Lepinë paraqiten më gjykatën e qarkut në Nish, Serbi. Më 11 maj, OSBE-ja u takua me kryetarin e gjykatës komunale të UNMIK-ut në Lipjan/Lipljan i cili e konfirmoi ekzistimin e kësaj gjykate paralele serbe në Lepina/Lepinë.<sup>30</sup>

<sup>28</sup> Për më shumë informata lexo kapitullin e parë, strukturat paralele të sigurisë, faqe 11.

<sup>29</sup> Për qëllime të një analizimi të hollësishëm të vendimeve përkritazi me të drejtat pronëso- juridike të lëshuara nga organet paralele administrative, lexo kapitullin tre, faqe 24.

<sup>30</sup> Kryetari deklaroi se dy gjyqtarë serbë të Kosovës ishin emëruar në gjykatën komunale në Lipjan/Lipljan, mirëpo ata nuk u paraqitën në punë fare. Kryetari ishte i besimit se vendimi i gjykatësit serbë të mos punojë për gjykatën

Kohëve të fundit shtypi është përqëndruar më shumë në çështjen e gjykatës paralele në Lepina/Lepinë. Gazeta ditore Zëri më 12 maj botoi artikullin si në vijim:

“Në fshatin Lepi të komunës së Lipjanit (rajoni i Prishtinës) funksionon një gjykatë paralele e udhëhequr nga dy gjyqtarë serbë [...]. Kuvendi Komunal në Lipjan informoi autoritetet e UNMIK-ut për punën e kësaj gjykate mirëpo gjer më tani UNMIK-u nuk ka bërë asgjë për ta ndaluar punën e kësaj gjykate edhe pse funksionimi i kësaj gjykate nuk është në pajtim me Rezolutën 1244. Gjykata komunale në Lipjan nuk pranon si të vlefshëm asnjë dokument të lëshuar nga kjo gjykatë paralele dhe apelon tek qytetarët se ata nuk bën t’i shfrytëzojnë shërbimet e kësaj gjykate, për shkak se ajo është vetëm humbje e kohës dhe parave.” [sic]

### **2.2.3 Rajoni i Gjilanit/Gnjilane**

Menjëherë pas përfundimit të konfliktit, gjykata komunale serbe në Gjilan/Gnjilane ishte zhvendosur në Vranje, përderisa gjyqi komunal në Štrpce/Shtërpçë ishte vendosur në Leskovac, të dyja këto qytete në Serbi. Megjithatë, në Štrpce/Shtërpçë, një zyre administrative e gjykatës paralele të Shtërpces e vendosur në Leskovac ende mbetet në këtë qytezë. Kjo zyre funksionon si një zyre e ndërlidhjes – nga kjo zyre kërkesat dërgohen në serbi për shqyrtim (gjykim). Zyra administrative e kësaj gjykate paralele vazhdon të përdor “Republika Srbija”.

### **2.2.4 Rajonet e Pejës/Peć dhe Prizrenit**

Nuk raportohet të ketë ndonjë gjykatë paralele në Prizren dhe Pejë/Peć, edhe pse gjykatat serbe në këto qytete janë vendosur në Serbi. Për shembull, gjykata komunale e Pejës është e vendosur në Leskovac, përderisa gjykata komunale e Prizrenit është vendosur në Krusevku. Lëndët me të cilat merren këto gjykata janë kryesisht lëndë pronëso-ro-juridike dhe të trashëgimisë.<sup>31</sup> Kryetari i Gjykatës Komunale në Pejë/Peć vërtetoi se kjo gjykatë nuk i trajton aktvendimet e gjykatës paralele si të vlefshme.

## **2.3 Efektet e sistemit të gjykatave paralele**

### **2.3.1 Norma e punës**

Që nga viti 1999, shumica e aktiviteteve të ndërmarra nga gjykatat paralele komunale në komunat veriore ishin të natyrës administrative, dhe kishin të bëjnë me lëshimin e autorizimeve, dosjet penale, vulosjen apo vërtetimin e dokumenteve e kështu me rradhë. OSBE-ja ka vërejtur se njerëzit kanë kërkuar ndihmën e gjykatave paralele në rastet kur aktvendimet e këtyre gjykatave nevojitet të pranohen në Serbi, për shembull në rastet e trashëgimisë. OSBE-së nuk i është lejuar t’i qaset dosjeve të të gjitha lëndëve që janë dësgjuar pranë gjykatave paralele. Sidoqoftë, kryetari i gjykatës paralele të qarkut në “Kosovska Mitrovica” raportoi se në periudhën prej mesit të qershorit 1999 deri në janar 2003, gjykata

---

komunale nuk ishte për shkak të arsyeve financiare mirëpo më shumë për shkak të presionit politik nga Beogradi. Kryetari deklaroi se kolegët e tij serbë janë gjithmonë të mirëseardhur t’i bashkohen kësaj gjykate dhe të fillojë me punë.

<sup>31</sup> Për më shumë informata lexo kapitullin tre, strukturat paralele administrative – çështjet pronëso-ro-juridike, faqe 24.

paralele komunale në rajonin e Mitrovicës dhe gjykata paralele e qarkut në Kraljevë, kanë dëgjuar këto lloje dhe këtë numër të rasteve të paraqitur si në vijim:<sup>32</sup>

Procedurë civilo-juridike:	723
Procedurë penale:	352
Procedurë hetimore: <sup>33</sup>	126
Procedurë trashëgimore:	628
Të ndryshme: <sup>34</sup>	1983
Përmbarime:	176
Vërtetimi i dokumenteve (Apostille): <sup>35</sup>	216
Vërtetimi i dokumenteve (Në përgjithësi): <sup>36</sup>	1011
Kërkesa për bashkëpunim profesional gjyqësor: <sup>37</sup>	59

Kryetari i gjykatës paralele të qarkut në Mitrovicë/Mitrovica, në një mbledhje të mbajtur më 8 maj, raportoi se gjykatat paralele kanë pushuar t'i dëgjojnë lëndët penalo-juridike. Gjyqtarët e gjykatës komunale të UNMIK-ut në Leposavić/Leposaviq gjithashtu e konfirmuan këtë mëvonë. Mëparë, në një mbledhje të mbajtur më 11 mars, kryetari i gjykatës paralele të qarkut theksoi se ekziston një rast i cili është në zgjidhje e sipër pranë gjykatës paralele të qarkut në Kraljevë, rast ky i gjykimit të dyfishtë për të njëjtën vepër penale (rrezikimit të dyfishtë). Aktakuza e akuzon të pandehurin për tentim vrasje. Sipas informatave të dhëna nga kryetari në fjalë, edhe gjykata e UNMIK-ut paraprakisht kishte shpallur fajtor të pandehurin e njëjtë për shkaktim të lëndimeve të rënda trupore, në bazë të të njëjtave fakte.

OSBE-ja është informuar se një rast i ngjashëm në të cilin i pandehuri ishte liruar nga gjykata paralele e qarkut në Kraljevë, për vrasje, pasi që kishte vuajtur paraburgimin në Serbi për 9 muaj mëparë. Pas kthimit të tij në Kosovë, hetimet gjithashtu u inicuan edhe nga gjykata e qarkut e UNMIK-ut në Mitrovicë/Mitrovica. I dyshuari paraprakisht kishte qenë në paraburgim për katër muaj nën akuzën për shkaktim të lëndimeve të rënda trupore që rezultojnë me vdekjen e viktimës, në bazë të të njëjtave fakte. Pas përfundimit të hetimeve prokurori ndërkombëtar tërhoqi aktakuzën në shkurt 2003 për shkak të mungesës së dëshmive të mjaftueshme. I dyshuari ishte liruar mëpastaj nga paraburimi. Mëpastaj, pala e dëmtuar, vajza e të vdekurit inicioi padi private kundër të akuzuarit për vepër penale të shkaktimin të lëndimeve të rënda trupore. Kjo lëndë për momentin është në zgjidhje e sipër.

OSBE-ja gjithashtu arriti të mbledh informata për lëndët që janë në zgjidhje e sipër pranë gjykatës komunale paralele në Leposavić/Leposaviq. Sipas ushtruesit të detyrës së kryetarit të kësaj gjykate, numri i lëndëve në zgjidhje e sipër pranë kësaj gjykate është paraqitur në vazhdim.

Numri i lëndëve në zgjidhje e sipër, të pranuar nga kjo gjykatë që nga periudha para vitit 1999:

<sup>32</sup> Rreth 95% të rasteve janë vendosur në nivel të gjykatës komunale. Shënimet e sakta për rastet të cilat arritën deri në shkallën e apelacionit nuk janë të dhëna në dispozicion. Shënimet nuk përfshijnë rastet në gjykatat për kundërvajtje.

<sup>33</sup> Numri i 'procedurave hetimore' i referohet rasteve që kanë rezultuar në procedura gjyqësore si dhe atyre që kanë përfunduar para se të hyjnë në fazën e procedurës gjyqësore.

<sup>34</sup> Kategoria e rasteve 'të ndryshme' përbëhet nga ato raste që kanë përfunduar me marrëveshje miqësore, hashtë gjykatës.

<sup>35</sup> Gjykata lëshon vula apostille për të vërtetuar origjinalitetin e dokumenteve të lëshuara nga gjykatat e huaja.

<sup>36</sup> 'Vërtetimi i dokumenteve' përfshin vërtetimet e dokumenteve siç parashihet me ligj siç është vulosja e kontratave, lëshimi i një deklarate të marrë nga dosja penale, etj.

<sup>37</sup> 'Kërkesa për bashkëpunim profesional gjyqësor' i referohen kërkesave për përkrahje ligjore gjykatave tjera goftë në Serbi dhe Mal të Zi apo edhe jashtë vendit.

Procedurë civile:	15
Procedurë penale:	13
Procedurë për hetime penale:	15
Procedurë e trashëgimisë:	5
Procedurë e përmbarimit:	30
Procedurë jashtëgjyqësore:	4

Numri i rasteve që janë në zgjidhje e sipër dhe që janë pranuar në periudhën prej mesit 1999 – 13 janar 2003:<sup>38</sup>

Procedurë civile:	87
Procedurë penale:	527
Procedurë hetimore:	24
Procedurë e trashëgimisë:	32
Procedurë e përmbarimit:	26
Procedurë jashtëgjyqësore:	6

Këto raste janë lënë në ndërtesën e gjykatës në Leposavić/Leposaviq nga autoritetet paralele. Departamenti i Drejtësisë i UNMIK-ut për momentin është duke vlerësuar se a munden dhe si munden këto lëndë të transferohen në sistemin e gjykatave të UNMIK-ut.

### 2.3.2 Zbatimi

Mjetet e zbatimit të aktvendimeve gjyqësore të gjykatave paralele janë të kufizuara dhe varen nga mjetet që i kanë në dispozicion gjykatat paralele dhe strukturat administrative. Zbatimi i hapur i aktvendimeve është i pamundur për shkak të pranisë së policisë së UNMIK-ut. Megjithatë, strukturat paralele administrative si duket ofrojnë disa mundësi për zbatim. Për shembull nëse kemi të bëjmë me një rast të kompenzimit me para aktvendimi mund të zbatohet nëpërmjet të “Byrosë për llogari dhe pagesa (Zavod za obracun i placanje),” që është e vendosur në Zvečan/Zveçan. Ky organ është një zëvendësim i organit që ka ekzistuar gjatë periudhës socialiste me emrin “Shërbimi i kontabilitetit shoqëror (Sluzba drustvenog knjigovodstva)”. OSBE-ja nuk ka dijeni se a është ky mekanizëm efikas.

Ende ekzistojnë zyret kadastrale në Leposavić/Leposaviq, Zvečan/Zveçan dhe Zubin Potok të cilat mbesin nën pushtetin serb, dhe të cilat zakonisht do të zbatojnë (ekzekutojnë) aktvendimet që kanë të bëjnë me kontestet pronëso- juridike. OSBE-ja është informuar nga drejtori i Zyrës kadastrale të Kosovës (me një zyrë të vetën në Leposavić/Leposaviq) se nuk janë bërë kurrfarë ndryshime në regjistrin kadastral që nga qershori 1999. Zyrat kadastrale serbe që veprojnë në Kosovë janë duke pranuar kërkesat për ndryshime, përfshirë këtu edhe aktvendimet gjyqësore për ndryshimin e titullarit të pronës, mirëpo këto zyre nuk do t’i bëjnë këto ndryshime përderisa nuk bihet ndonjë vendim mbi punën e regjistrit kadastral. Për momentin këto zyre kadastrale lëshojnë vetëm deklarata pronëso- juridike siç janë listat poseduese pas kërkesës së bërë.<sup>39</sup>

## 2.4 Analiza

### 2.4.1 Shqetësimet e tanishme

Qëllimi kryesor i Dokumentit të përbashkët dhe mëpastaj edhe Deklaratës së përbashkët<sup>40</sup> është të inkurajohen gjyqtarët dhe prokurorët serbë të aplikojnë për pozita në kuadër të

<sup>38</sup> 13 janar 2003 është data në të cilën edhe zyrtarisht u hap gjykata komunale e UNMIK-ut në Leposavić/Leposaviq.

<sup>39</sup> Për më shumë informata lexo kapitullin tre, strukturat administrative paralele – çështjet pronëso- juridike, faqe 24.

<sup>40</sup> Deklarata e përbashkët mbi rekrutimin e gjyqtarëve dhe prokurorëve të përkatësisë etnike serbe në sistemin multietnik të drejtësisë në Kosovë, 9 korrik 2002.

sistemit gjyqësor të UNMIK-ut. Në këtë aspekt, UNMIK-u ka arritur një sukses të pjesërishëm. Gjykatat janë hapur në Zubin Potok dhe Leposavić/Leposaviq, dhe gjithsejt 11 gjyqtarë serbë tani punojnë në kuadër të gjykatave të UNMIK-ut. Në anën tjetër, Ministria serbe e Drejtësisë ka përmbytur detyrimet e saj që dalin nga Deklarata e përbashkët jo edhe me aq entuziazëm, dhe kjo i ka lënë kandidatët e mundshëm në një pozitë të palakmueshme. Ministria serbe e Drejtësisë ka dërguar porosi të përziera gjer më tani. Nuk është e qartë, për shembull se a do të vazhdojnë gjyqtarët dhe prokurorët serbë të pranojnë beneficione sociale nga qeveria serbe. Ajo i dorëzoi Parlamentit serb një propozim duke deklaruar se përkohësisht do të suspendojë juridikcionin e sistemit gjyqësor serb në Kosovë derisa Kosova të mbetet nën administrimin e UNMIK-ut, mirëpo ky propozim u tërhoq më vonë. Në kohën e përpilimit të këtij raporti, OSBE-ja kuptoi se Ministria e Drejtësisë përfundi i ka rekomanduar qeverisë serbe që përkohësisht të suspendojë juridikcionin e sistemit gjyqësor serb në Kosovë dhe të përqëndrohet në absorbimin e stafit të gjykatave kosovare në serbi në kuadër të gjykatave të vetë Serbisë. Mbetet të shihet se a do të kthehen këto rekomandime në praktikë.

Gjyqtarët dhe prokurorët serbë hezitojnë të aplikojnë për funksione në kuadër të sistemit gjyqësor të UNMIK-ut për shkak se autoritetet serbe ende ofrojnë kushte më të mira të punës. Për shembull, UNMIK-u ofron paga më të ulëta dhe më pak beneficione tjera. Për momentin, serbët e Kosovës preferojnë të jetojnë dhe punojnë në Serbi.

Përkundër hapjes së gjykatave të UNMIK-ut në komunat veriore, ende ekziston një paqartësi në mesin e popullatës se në cilës gjykatë t'i qasen. Serbët e Kosovës ende kohëpaskohe për disa çështje kërkojnë ndihmë nga gjykatat paralele. Një shembull i mirë janë çështjet administrative. Në disa raste gjykatat e UNMIK-ut nuk kanë qenë në gjendje të vërtetojnë deklaratat e caktuara, siç janë deklaratat se a ka pasur dikush dosje penale para qershorit 1999, për shkak se dosjet përkatëse posedohen nga gjyqësia serbe. Aplikantët që kanë nevojë për lëshimin e deklaratave të tilla, për shembull për qëllime të marrjes së vizës kërkojnë drejtpërdrejt ndihmë nga gjykatat serbe në vend se të kërkojnë nga gjykatat e UNMIK-ut që ato t'i dërgojnë letër organeve gjyqësore në Beograd. Për t'ju shmangur paqartësive, shumë individë tentojnë të aplikojnë për lëshimin e të njëjtave dokumente si pranë gjykatave paralele ashtu edhe pranë atyre të UNMIK-ut.

Gjykatat e sapohapura të UNMIK-ut në Leposavić/Leposaviq dhe Zubin Potok kanë kapacitete të pakëta. Vetëm një gjyqtar punon në secilën nga dy gjykatat. Vetëm një numër i vogël i rasteve arrijnë në procedurë, ndërsa sa i përket lëndëve penale nuk mund të krijohet trupi gjyqësor. Prandaj, edhe më tej, rastet i referohen gjykatës në Mitrovicë/Mitrovica. Funksionimi i kufizuar i gjykatave të UNMIK-ut në Leposaviq/Leposavić ishte shfrytëzuar si argument nga ana e ish kryetarit të gjykatës paralele për të arsyetuar rihapjen e gjykatës paralele. Duke pasqyruar se gjykatat e UNMIK-ut ishin hapur para nëntë muajsh, ky argumentim ishte përqafuar edhe nga popullata<sup>41</sup>.

#### **2.4.2 Aktvendimet gjyqësore të kaluara të gjykatave paralele**

Një çështje e cila duhet adresuar nga UNMIK-u është statusi i lëndëve të cilat janë vendosur nga gjykatat paralele kur ato ishin aktive – ndërmjet vitit 1999 dhe 2002. Gjatë kësaj kohe, UNMIK-u kishte ushtronte kontroll të kufizuar në komunat veriore të Kosovës. Edhe pse gjykatat e UNMIK-ut në Mitrovicë/Mitrovica kanë juridikcion zyrtar në këto territore, shumë lëndë zgjidhen në gjykatat paralele. UNMIK-u ende nuk ka marrë vendim se si të vlerësojë ligjshmërinë e aktvendimeve apo veprimeve të ndërmarra nga gjykatat paralele gjatë kohës kur ato kanë funksionuar. Për më tepër, UNMIK-u ende nuk ka përcaktuar procedurën për transferimin e lëndëve që janë inicuar në gjykatat paralele në kuadër të sistemit gjyqësor të UNMIK-ut. Siç qëndron situata për momentin është e paqartë nëse transaksionet pronësore të vërtetuara nga gjykatat paralele kanë vlerë ligjore, apo nëse hipotekat e vërtetuara nga

<sup>41</sup> Lexo faqe 18: përpjekjet për të rihapur gjykatën paralele komunale në Leposaviq/Leposavic.

gjykatat paralele ende janë në fuqi. E njëjta vlen edhe për vendimet për shkurorëzim apo pagesën e alimentacionit nga gjykatat paralele. Për momentin nevojitet të mirret një vendim mbi atë se a janë ato çifte të martuara apo shkurorëzuara apo se a duhet të pushojë pagesa e alimentacionit apo jo.

Ekzistojnë dy zgjidhje të mundshme: krijimi i mekanizmave adekuat për vlerësimin e vlefshmërisë ligjore të aktvendimeve dhe veprimeve të ndërmarra nga gjykatat paralele dhe transferimin e rasteve të pazgjidhura në këto gjykata apo edhe përcaktimi se aktvendimet e këtyre gjykatave nuk kanë vlerë ligjore. Në të vërtetë nëse UNMIK-u nuk adreson këto probleme atëherë si rezultat do të kemi mos njohjen ligjore të aktvendimeve të gjykatave paralele, për shkak se UNMIK-u dhe gjyqësia vendëse shpeshherë kanë bërë me dije se aktivitetet gjyqësore të gjykatave paralele nuk janë të vlefshme.

Mos njohja e aktvendimeve gjyqësore të gjykatave paralele mund të justifikohet edhe në baza se strukturat paralele janë të paligjshme në bazë të Rezolutës së KS të KB-ve 1244 (1999) dhe për këtë arsye të gjitha vendimet dhe veprimet e tyre janë të paligjshme. Një zgjidhje e tillë mund të mos jetë e përkryer dhe mund të krijojë probleme sociale. Për shembull, disa njerëz mund të përfirojnë nga kjo paqartësi ligjore dhe të mos e paguajnë alimentacionin apo të mos i paguajnë kreditë e marra apo madje edhe të përpiqen të marrin për vete pronën e transferuar. Së dyti një zgjidhje e tillë mund të injorojë faktin se serbët e Kosovës të cilët jetojnë në komunat veriore janë mbështetur në punën e gjykatave paralele me qëllim të mbrojtjes së interesave të tyre. Funksionimi i gjykatave të tilla në këto komuna nuk ishte penguar fare në periudhën në mes të vitit 1999 dhe 2003, për shkak se gjykatat e UNMIK-ut ende nuk ishin themeluar në atë kohë. Andaj banorëve të këtyre komunave nuk i'u ishte lënë ndonjë opcion tjetër përpos të kërkojnë ndihmë nga gjykatat paralele. Politika e qeverisë së Serbisë për mbajtjen e këtyre gjykatave e fuqizon edhe mëtej këtë përshtypje. Shpallja e aktvendimeve të gjykatave paralele si të pavlefshme do të ndikojë në ata individë të cilët prezumojnë se aktvendimet e këtyre gjykatave kanë fuqi ligjore në Kosovë.

Mos njohja e përgjithshme e aktvendimeve të gjykatave paralele mund të krijojë probleme siç demonstron edhe nga shembujt e paraqitur si në vijim. Në vitin 2001, një individ parashtriu ankesë kundër aktvendimit gjyqësor të marrë nga gjykata komunale e Mitrovicës para vitit 1999, e cila është e vendosur në Kraljevë sa i përket shumës së kompenzimit të caktuar në bazë të procedurës së ekspropriimit. Në vitin 2002, i brengosur për vlefshmërinë ligjore të aktvendimeve të marra nga gjykata paralele e qarkut të Mitrovicës, një individ shkoi tek kryetari i gjykatës së qarkut të UNMIK-ut në “Mitrovicë/Mitrovica, ku ky i fundit e këshilloi parashtruesin e ankesës që ose të iniciojë procedurën pranë gjykatës së shkallës së parë të UNMIK-ut ose të pres shpërndarjen e gjykatës paralele të qarkut të “Kosovska Mitrovicës” dhe të pres derisa të bëhet transferimi i lëndëve në gjykatën e qarkut të UNMIK-ut në Mitrovicë/Mitrovica. Një individ kishte një kontratë blerje të një banese në pronësi shoqërore e cila ishte vërtetuar nga gjykata paralele komunale në Mitrovicë/Mitrovica në shtator 2000. Në vitin 2002, pronari i banesës ia kishte shitur banesën një pale të tretë mirëpo gjykata komunale e UNMIK-ut në Mitrovicë/Mitrovica refuzoi të vërtetoi kontratën e shitblerjes duke u arsyetuar në baza se kontrata e blerjes e vërtetuar nga gjykata komunale paralele nuk ka vlerë ligjore. Nëpunësi i gjykatës komunale e këshilloi individin që të shkojë tek oficeri ligjor komunal (OLK) në Mitrovicë/Mitrovica për të përcaktuar vlefshmërinë ligjore të kontratës së shitblerjes së vitit 2000. OLK-ja e informoi individin në fjalë se ai nuk ishte kompetent të bëjë një përcaktim të tillë.

#### ***2.4.3 Rastet e pazgjidhura në gjykatat paralele***

UNMIK-u edhe nuk ka marrë vendim përkitazi me transferimin e rasteve të pazgjidhura nga gjykatat paralele në gjykatat e UNMIK-ut. Ridorëzimi i rasteve gjykatave përkatëse të UNMIK-ut mund të jetë një proces i thjeshtë, mirëpo mund të ekzistojnë probleme përkitazi me atë se kur fillon parashkrimi i veprës penale. Për më tepër nëse një rast bartet në gjykatën



e UNMIK-ut, duhet të vendoset se si të trajtohet dosja penale e atij rasti, se a duhet të fillohet procedura që nga fillimi apo a duhet procedurat e filluara prej qershorit 1999 deri në janar 2003 të trajtohen si të vlefshme apo jo. Për më tepër duhet të mirret një vendim se si duhet trajtuar rastet e pazgjidhura para qershorit të vitit 1999. Nevoja për të adresuar këto çështje me urgjencë tregohet edhe me hapjen e gjykatës komunale paralele në Leposavić/Leposaviq. Sipas informatave të OSBE-së, gjykata paralele ishte rihapur për shkak të paaftësisë së gjykatës së sapothemeluar të UNMIK-ut për t'i zgjidhur rastet e pazgjidhura.

*Kapitulli i tretë*

**STRUKTURAT PARALELE ADMINISTRATIVE  
ÇËSHTJET PRONËSORO-JURIDIKE**

### 3.1 Historiku dhe çështjet

Sipas ligjit në fuqi, autoritetet komunale në Kosovë janë kompetente për rregullimin e shfrytëzimit dhe kontrollimit të pronës në kuadër të kufijve të komunës. OSBE-ja ka vërejtur një numër të strukturave administrative të cilat janë kompetente për rregullimin e çështjeve pronësoro-juridike në Kosovë dhe të cilat funksionojnë nën pushtetin e Beogradit, përkundër themelimit të administratës civile të UNMIK-ut. Këto struktura administrative janë veçanërisht të njohura në komunat Zvečan/Zveçan, Zubin Potok dhe Leposavić/Leposaviq. OSBE-ja gjithashtu ka vërejtur se funksionojnë edhe zyret kadastrale paralele të cilat janë të vendosura në Serbi.

Gjendja në komunat veriore duhet të shqyrtohet në dritën e zhvillimeve në rajon. Së pari jo të gjithë administratorët regjional dhe komunal ishin emëruar deri në shtator 1999. Së dyti vetëm në tetor 2000 UNMIK-u përfundoi me emërimin e anëtarëve të Kuvendit Komunal në Mitrovicë/Mitrovica; në nëntor 2000, ky emërim u krye edhe në Zvečan/Zveçan; në dhjetor 2000 edhe në Zubin Potok; përderisa në janar 2001 emërimet u kryen edhe në Kuvendin Komunal në Leposavić/Leposaviq.

Pas emërimit të anëtarëve të kuvendeve komunale në fjalë, të cilat mëpastaj filluan të veprojnë në bazë të Rregullores së UNMIK-ut 2000/45,<sup>42</sup> drejtoratet e njëjta për urbanizëm dhe zyret kadastrale të cilat funksiononin nën pushtetin serb, u pranuan në mënyrë zyrtare nga organet e UNMIK-ut. Megjithatë, lidhja e tyre me Beogradin nuk u prish, për shkak se këto organe administrative të pranuar nga UNMIK-u e citojnë ligjin serb<sup>43</sup> se bazë ligjore për marrjen e vendimeve dhe shfrytëzojnë vulën e Republikës së Serbisë.

Masa deri në të cilën Beogradi ushtron ndikim në komunat veriore mund të ilustruhet edhe nëpërmjet të disa shembujve nga Kuvendi Komunal në Leposavić/Leposaviq. Së pari, Kuvendi Komunal lëshoi një dokument në mars 2003 duke bërë me dije se cilat ja ë ato objekte të ndërtuara në mënyrë të paligjshme dhe duke përcaktuar kushtet për legalizimin e tyre. Dokumenti në fjalë mbante vulën e Republikës së Serbisë dhe i referohej ligjit të ish Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë i cili kishte hyrë në fuqi në vitin 1990.<sup>44</sup> Së dyti, në njërën nga seancat e tij të fundit, Kuvendi Komunal diskutoi edhe për implementimin e legjislacionit mbi rregullimin e ndërtimeve të paligjshme, e cila ishte nxjerrur nga Republika e Serbisë. Edhe pse oficeri ligjor komunal i UNMIK-ut ishte i pranishëm në këtë seancë të Kuvendit Komunal ai nuk ndërhyu që të kontestoi zbatueshmërinë e këtij legjislacioni.<sup>45</sup> Kryetari i Kuvendit Komunal mëpastaj deklaroi se Kuvendi Komunal do të zbatojë dy kornizat ligjore si atë të UNMIK-ut ashtu edhe atë të Republikës së Serbisë<sup>46</sup>.

Një problem tjetër sa i përket të drejtave pronësore në Kosovë është se shumë shënime kadastral mbi pronat në Kosova janë bartur në Serbi menjëherë pas përfundimit të konfliktit. Së këndejmi, ekziston një huti rreth vlefshmërisë së listave poseduese (shënimeve kadastrale) të lëshuara në Serbi.

Cenimi i të drejtave pronësoro-juridike ka rezultuar nga funksionimi i strukturave administrative në kontekstin e përshkruar më lartë. Me qëllim të përmirësimit të kësaj situatë,

<sup>42</sup> Mbi vetëqeverisjen e komunave në Kosovë.

<sup>43</sup> “Ligji serb” këtu nënkupton ligjin i cili nuk zbatohet në Kosovë. Ju lutemi të keni parasyshë se ligji serb ende është i zbatueshëm në Kosovë duke u bazuar në Rregulloren e UNMIK-ut 1999/24 mbi ligjin në fuqi në Kosovë.

<sup>44</sup> Vendimi nr. 353-3 i Kuvendit Komunal i datës 11 mars 2003. Vendimi thekson se pas skadimit të afatit për legalizim të ndërtimeve të paligjshme, ato do të hiqen me shpenzime të pronarëve.

<sup>45</sup> Në të njëjtën seancë, nënkryetari dhe kryeshefi ekzekutiv ishin thirrur tradhtarë nga pjesëtarët e publikut të përgjithshëm për shkak se kishin punuar në kundërshtim me direktivat e lëshuara nga Qendra koordinuese për Kosovën dhe qeveria e Serbisë dhe Malit të Zi që në mënyrë retroaktive të legalizohen të gjitha ndërtesat e ndërtuara në mënyrë të paligjshme.

<sup>46</sup> Lexo fusnotën nr.41

duhet të përcaktohet se a kanë vlefshmëri ligjore vendimet e tilla të lëshuara nga organet administrative në fjalë para dhe pas themelimit të UNMIK-ut.

### **3.2 Strukturat administrative paralele të vendosura në territorin e Kosovës**

#### **3.2.1 Drejtoratet komunale për urbanizëm**

OSBE-ja ka vërejtur një numër të vendimeve mbi çështjet pronësore të lëshuara nga drejtoratet për urbanizëm në Zvečan/Zveçan, Zubin Potok dhe Leposavić/Leposaviq nga mesi i vitit 1999 deri në vitin 2003 të cilat mbanin vultat e Republikës së Serbisë dhe atë në alfabetin çirilik. OSBE-ja gjithashtu kishte identifikuar se vendimet e lëshuara nga drejtoratet komunale për urbanizëm në Zubin Potok mbajnë edhe vulën e UNMIK-ut edhe atë të Republikës së Serbisë të nënshkruara nga Përfaqësuesi Komunal i UNMIK-ut dhe drejtori i Drejtoratit komunal për Urbanizëm në Zubin Potok.<sup>47</sup>

#### **3.2.2 Zyret kadastrale komunale**

Në komunat Leposavić/Leposaviq, Zubin Potok dhe Zvečan/Zveçan, zyret komunale kadastrale të pranuar nga UNMIK-u ende funksionojnë nën pushtetin e administratës së gjeodezisë së Republikës së Serbisë. OSBE-ja ka vërejtur se dokumentacioni i lëshuar nga ZKK-të shkakton huti të madhe sa i përket vlefshmërisë së tij. Për shembull, ZKK në Zubin Potok lëshoi një listë poseduese në shkurt 2002, me titullin Administrata e gjeodezisë së Republikës së Serbisë edhe pse mbante vulën e UNMIK-ut. Fakti se organet e tilla administrative të pranuar nga UNMIK-u janë ende të ndikuara nga Beogradi krijon një paqartësi të madhe ligjore. OSBE, ka identifikuar një numër ankesash nga pjesëtarët e komuniteteve të pakicave në rajonet kur serbët e Kosovës paraqesin shumicën, lidhur me lëshimin e dokumentacionit me titull “Administrata gjeodezike e Republikës së Serbisë” nga ana e zyrtarëve komunal të komuniteteve të këtyre komunave<sup>48</sup>.

### **3.3 Zyret paralele kadastrale në Serbi**

Pas qershorit 1999, shumica e shënimeve kadastrale që kanë të bëjnë me pronat që gjenden në territorin e Kosovës ishin bartur në serbi. Agjencia kadastrale e Kosovës e ka informuar OSBE-në se draft Protokolli për kthimin e shënimeve të bartura kadastrale në Serbi është pranuar si nga Agjencia kadastrale e Kosovës ashtu edhe nga Administrata e gjeodezisë e Republikës së Serbisë. Megjithatë, nënshkrimi i draft Protokollit është ndalur për momentin për shkak të ngecjes së dialogut UNMIK-Beograd.

Në bazë të AKK-së, zyra kadastrale në Krushevc, Serbi ka shënime kadastrale të cilat mbulojnë tërë territorin e Kosovës. Duket se edhe zyret tjera kadastrale në Serbi mund të posedojnë shënime kadastrale mbi pronat në Kosovë. AKK-ja ka përmendur se zyrra paralele kadastrale mund të ndodhet në Nish. Për momentin UNMIK-u nuk ka përcaktuar ende vlefshmërinë ligjore të listave poseduese të lëshuara në Serbi, e as nuk e ka adresuar çështjen se a duhet të konsiderohen këto lista poseduese të vlefshme apo jo.

### **3.4 Vlefshmëria ligjore e vendimeve të strukturave paralele administrative**

#### **3.4.1 Vlefshmëria ligjore e vendimeve të lëshuara nga strukturat administrative para themelimit të UNMIK-ut dhe ato të pranuar nga UNMIK-u dhe mungesa e mjeteve juridike**

OSBE-ja paraprakisht kishte shqyrtuar çështjen e vlefshmërisë ligjore të vendimeve të lëshuara nga strukturat administrative para dhe pas themelimit të UNMIK-ut në komunat

<sup>47</sup> Për shembull, vendimi nr. 08-354-467, i datës 11 nëntor 2002.

<sup>48</sup> Në shtator 2003, zyrtari ligjor i UNMIK-ut për komunën e Leposaviqit/Leposavic e ka informuar OSBE-në lidhur me një ankesë të tillë të bërë nga një rom i Kosovës. Ankesa të ngjajshme janë paraqitur edhe nga shqiptarët e Kosovës që jetojnë në komunën e Zubin Potokut, ku serbët e Kosovës janë shumicë.

veriore.<sup>49</sup> Ky problem ilustronet nëpërmjet dy rasteve nga Leposaviqi. Qasja e paqëndrueshme nga zyrtarët e ndryshëm të UNMIK-ut përkitazi me njohjen e vendimeve të lëshuara nga këto struktura sikurse edhe mungesa e mjeteve juridike efikase për individët të drejtat pronësore të të cilëve janë cenuar, janë të potencuara në këtë raport.

#### *3.4.1.1 Vlefshmëria juridike e vendimeve të marra nga organet para vendosjes së plotë të pushtetit të UNMIK-ut*

Në rastin e parë në Leposavić/Leposaviq, në dhjetor 2000, një individ pasi kishte aplikuar pranë organeve komunale atij i ishte dhënë leja për të shfrytëzuar tokën me qëllim të ndërtimit të një pompe të benzinës.<sup>50</sup> OSBE-ja kupton se edhe pse administratori komunal i UNMIK-ut në Leposavić/Leposaviq ishte emëruar në vitin 1999, UNMIK-u nuk ushtroi pushtet të plotë deri në dhjetor të vitit 2000.<sup>51</sup> Në mars 2003, përfaqësuesi komunal i UNMIK-ut dhe oficeri ligjor i UNMIK-ut në Leposavić/Leposaviq i bëri me dije OSBE-së se Shërbimi i Doganave të UNMIK-ut është duke kërkuar rrënimin e pompës së benzinës nëpërmjet të administratës komunale të UNMIK-ut në baza se UNMIK-u nuk pranon lejet e lëshuara nga organet komunale në dhjetor të vitit 2000.

OSBE-ja vëren se paqartësia ligjore në lidhje me vlefshmërinë e vendimeve administrative të lëshuara nga organet administrative para vendosjes së pushtetit të plotë nga ana e UNMIK-ut është mjaft evidente në komunat veriore. OSBE-ja është e brengosur se të drejtat e individëve të cilët në atë kohë kishin bazë të arsyeshme për të besuar se po kërkonin shërbim nga një strukturë legjitime, janë duke u cenuar për shkak se vendimet para UNMIK-ut janë duke u trajtuar si të pavlefshme.

#### *3.4.1.2 Vlefshmëria juridike e vendimeve të lëshuara nga strukturat administrative të pranuar nga UNMIK-u*

Në një rast të dytë në Leposavić/Leposaviq, inspektorët e drejtoratit komunal për urbanizëm të pranuar nga UNMIK-u në Leposavić/Leposaviq, i cili funksionon nën ndikim të vazhdueshëm nga Beogradi, lëshuan në nëntor 2002 disa vendime, me të cilat autorizohet rrënimi i kiosqeve të cilat janë ngritur pa leje.<sup>52</sup> Të gjitha këto vendime mbanin vulën e Republikës së Serbisë dhe për këtë arsye pronarët e kiosqeve përballëshin me një paqartësi ligjore sa i përket vlefshmërisë së këtyre vendimeve. Krahas kësaj, procedura e ankesës për kundërshtimin e vendimeve të lëshuara nga drejtorati komunal për urbanizëm i pranuar nga UNMIK-u në Leposavić/Leposaviq është e paqartë dhe nuk është në pajtim me ligjin e zbatueshëm.<sup>53</sup>

Sa i përket vlefshmërisë së listave poseduese të lëshuara nga UNMIK-u nga ZKK-të e pranuar nga UNMIK-u të cilat funksionojnë nën pushtetin e Beogradit, kjo paqartësi në lidhje me vlefshmërinë e tyre si dëshmi e titullarit të pronës u bë me dije kur administratori rajonal i UNMIK-ut për gjykatat në Mitrovicë/Mitrovica u konsultua me OSBE-në përkitazi me vlefshmërinë ligjore të këtij dokumentacioni.<sup>54</sup> Krahas kësaj, oficeri i UNMIK-ut për komunitetet lokale në Zubin Potok pranoi disa ankesa nga shqiptarët e fshatit Çabër/Čabra, të

<sup>49</sup> Departamenti për të drejtat e njeriut dhe sundimit të së drejtës, Raporti javort, 7-13 prill 2003.

<sup>50</sup> Leja e ndërtimit e lëshuar nga Drejtoria për urbanizëm i komunës së Leposaviqit, i datës 12 dhjetor 2000.

<sup>51</sup> Emërimi i administratorit komunal në Leposavić/ Leposaviq është i raportuar gjithashtu edhe në kuadër të raportit të përpiluar nga Qendra regionale e OSBE-së në Mitrovicë, më 28 shtator 1999.

<sup>52</sup> Vendimi nr. 354/15 deri në 20.

<sup>53</sup> Vendimet e lëshuara nga departamenti komunal për urbanizëm në Leposavić/Leposaviq parashikonin se “pronarët” e kiosqeve kishin 10 ditë për të parashtruar ankesë kundër vendimeve në fjalë “bordit të ankesave.” Identifikimi i këtij “bordi të ankesave” si organ i shkallës së dytë është i paqartë dhe afati kohor për iniciimin e procedurës së ankesës nuk është në pajtim me ligjin e zbatueshëm.

<sup>54</sup> Në bazë të rregullave të dëshmimeve të Drejtoratit për çështje pronësore dhe banesore dhe Komisionit për kërkesa pronësore dhe banesore (DÇBP/KKP), shënimet kadastrale përbëjnë vetëm dëshmi mbështetëse, për shkak të nivelit të pasaktësisë të shënimeve kadastrale.

komunës së Zubin Potok-ut, se listat poseduese të cilat lëshohen nga ZKK-ja me titull administrata e gjeodezisë së Republikës së Serbisë.

Çështja se a duhet një organ administrativ i njohur nga UNMIK-u t'i shqyrtojë vendimet e marra nga organet administrative para vendosjes së UNMIK-ut (p.sh vendimet e lëshuara duke u bazuar në ligjet e RSFJ-së dhe të cilat mbajnë vulën e Republikës së Serbisë), me qëllim të dhënies së një përcaktimi ligjor të zbatueshëm në këtë drejtim, ende mbetet të sqarohet në të ardhmen.

#### *3.4.1.3 Hutia rreth mjeteve juridike*

Është me rëndësi kryesore që individët të kenë të drejtë për ankesë kundër vendimeve që ndikojnë në të drejtat pronësoresh juridike pranë organit i cili është kompetent të përcaktojë plotëfuqishmërinë ligjore të aktvendimeve të lëshuara nga strukturat e tilla administrative. OSBE-ja ka identifikuar një sërë rastesh kur organet komunale nuk janë të sigurta se kush është ai organ administrativ i shkallës më të lartë. Drejtori i tanishëm i drejtoratit komunal të UNMIK-ut për urbanizëm në Leposavić/Leposaviq informoi OSBE-në se sipas mendimit të tij ministria përkatëse në Beograd është kompetente për të pranuar ankesat kundër vendimeve të lëshuara nga drejtorati komunal për urbanizëm. Në kundërshtim të qartë me këtë në komunën e Zubin Potokut, duke pasur parasysh mungesën e qartësisë përkitazi me atë se kush është ai organ më i lartë administrativ, vendimi i lëshuar nga struktura administrative e pranuar nga UNMIK-u e cila citon ligjet e RSFJ-së dhe mban vulën e Republikës së Serbisë duhet të rishikohet nga Ombudspersoni në Kosovë.<sup>55</sup>

OSBE-ja më heret ka raportuar për një huti të veprimit dhe një mungesë të vetëdijes në mesin e organeve komunale përkitazi me organin e lartë administrativ i cili është kompetent të shqyrtojë plotëfuqishmërinë e vendimeve administrative të shkallës së parë të lëshuara nga organet e rregullta të pranuar nga UNMIK-u (të cilat nuk funksionojnë nën ndikimin e Beogradit).<sup>56</sup> Për ta sqaruar këtë situatë, janë bërë përpjekje përmes ngarkimit të përgjegjësive në Drejtorinë e punëve administrative që kjo e fundit t'i bashkërendisë punët e menaxhimit të shqyrtimeve në shkallë të dytë të vendimeve administrative komunale. Drejtorja i procedon dhe i shpërndanë të gjitha ankesat në shkallë të dytë nëpër organet qofshin ato me kompetenca të transferuara ose në ato me kompetenca të rezervuara për të vendosur mbi to.

Në praktikë, nuk është bërë asnjë rishqyrtim i vendimeve administrative të lëshuara nga drejtoritë komunale të urbanizmit në Zubin Potok, Zvečan/Zvecan dhe Leposaviq/Leposavic nga ndonjë organ më i lartë administrativ. Zyrtarët komunal të drejtorisë së urbanizmit nga komuna e Zvečanit/Zvecan dhe Leposaviçit/Leposavic e kanë njoftuar OSBE-në se organi më i lartë administrativ që është kompetent për shqyrtimin e vendimeve të tilla është ministria përkatëse në Beograd.

Përveç kësaj, është e paqartë se cilat janë mjetet juridike në disponim dhe cila është procedura administrative e cila duhet të respektohet atëherë kur individëve u janë lëshuar aktvendime nga organet administrative para vendosjes së UNMIK-ut.

#### *3.4.2 Vlefshmëria ligjore e shënimeve kadastrale në Serbi*

Sa i përket ekzistimit të zyreve paralele kadastrale në Serbi, një shqetësim kryesor mbetet ende vlefshmëria ligjore e listave poseduese të lëshuara nga këto zyre në periudhën nga viti 1999 e gjer më sot. Për shembull një zyre kadastrale e vendosur në Vranje pohohet se lëshon lista poseduese përkitazi me pronat që ndodhen në rajonin e Gjilanit/Gnjilane. Sipas kryetarit të Kuvendit Komunal në Kamenicë/Kamenica, këto lista poseduese mbajnë vulën e

<sup>55</sup> Institucioni i Ombudspersonit nuk përfaqëson ndonjë mjet juridik efikas për shkak se vendimet e këtij organi nuk janë të ekzekutueshme.

<sup>56</sup> Lexo raportin e OSBE-së mbi të drejtat pronësore në Kosovë (2002-2003), faqe 58.

Republikës së Serbisë dhe vendin e lëshimit të tyre e theksojnë si Kamenicë/Kamenica.<sup>57</sup> Kryetari i Kuvendit Komunal në Kamenicë/Kamenica informoi OSBE-në se organet administrative bë Kosovë nuk i pranojnë listat poseduese të cilat lëshohen nga zyret kadastrale në Serbi si të vlefshme. Megjithatë, ekziston një paqartësi në mesin e agjencive për rindërtim se a kanë vlerë ligjore listat poseduese të lëshuara nga zyret kadastrale në Serbi dhe a janë ato dëshmi e pranueshme për posedimin e të drejtave pronësore me qëllim të ndarjes së ndihmës në rindërtim përfituesve të kësaj ndihme.

Efekti i bartjes së titullarit të pronës që ndodhet në Kosovë dhe vërtetimi i saj nga gjykatat në Serbi e komplikon këtë situatë edhe mëtej. Sipas AKK-së, edhe nëse gjykata serbe ka vërtetuar bartjen e titullarit të pronës, në shënimet kadastrale në serbi nuk janë bërë kurrfarë ndryshimesh që nga qershori 1999; nuk është bërë ndonjë zbatim i aktvendimeve të gjykatave serbe mbi vërtetimin e bartjes së titullarit të pronës në shënimet kadastrale në Serbi që nga qershori 1999. Për këtë arsye ngritet çështja se a duhet *de facto* një bartës i të drejtës pronësore në pajtim me bartjen e paregjistruar mirëpo të vërtetuar nga gjykata serbe e titullarit të pronës të trajtohet si një bartës *bona fide* i të drejtës pronësore në bazë të ligjit të zbatueshëm në Kosovë.

---

<sup>57</sup> OSBE-ja ende duhet të vërtetojë saktësinë e deklaratave të kryetarit të Kuvendit Komunal në Kamenicë/Kamenica.

*Kapitulli i katërt*

**SHKOLLAT PARALELE**



#### 4.1 Strukturat

Para konfliktit, popullata shqiptare kosovare kishte pasur shkollat e tyre, të cilat ishin udhëhequr paralelisht me sistemin shkollor serb. Pas konfliktit, rolet janë ndërruar dhe tani është sistemi serb i cili është paralel me atë shqiptar të Kosovës. Për arsye se prindërit serbë ndjejnë se shkollat e përziera fillore nëpër komunat e tyre janë jo të sigurta dhe jo të qëndrueshme për fëmijët e tyre, shkollat fillore, në disa raste janë të vendosura nëpër shtëpi private dhe nëpër disa objekte të cilat janë nën standard, siç kishte qenë rasti me shqiptarët kosovarë para konfliktit.

Të gjitha shkollat fillore dhe të mesme të cilat gjinden në enklavat ose nëpër komunat ku shumica e popullatës janë serbë i përdorin planprogramet e Ministrisë serbe të Arsimit dhe Sportit (MSAS). MSAS i siguron këtyre shkollave tekstet mësimore, diplomat dhe vulat. Si arsimtarët, ashtu edhe punëtorët tjerë arsimor janë nën mbikqyrjen e MSAS, dhe marrin pagat si nga MSAS, ashtu edhe nga Ministria për Arsim Shkencë dhe Teknologji (e Kosovës).<sup>58</sup>

Në rajonin e Mitrovicës, të gjitha shkollat fillore dhe të mesme të cilat gjinden në komunat e Zubin Potokut, Leposaviqit/Leposavic, Zveçanit/Zvečan, si dhe në pjesën veriore të Mitrovicës/Mitrovica janë nën qeverisjen e drejtpërdrejt të MSAS- it. E njëjta gjë zbatohet edhe në Banjë/Banjska të komunës së Skenderajt/Serbica, Gracë/Grace, Gojbulë/Gojbulja dhe Prilluzhë/Priluzje në komunën e Vushtrrisë/Vucitrn.

Në rajonin e Prishtinës/Pristina janë identifikuar shkollat fillore dhe ato të mesme në Fushë Kosovë/Kosovo Polje, në Prishtinë/Pristina (vetëm në pjesët rurale në veri dhe në jug) , në Lipjan/Lipljan dhe në Obiliq/Obilic.

Në rajonin e Gjilanit/Gnjilane janë identifikuar këto shkolla fillore dhe të mesme në sistemin paralel: shtatë shkolla fillore dhe gjashtë shkolla të mesme në komunën e Gjilanit/Gnjilane, katër shkolla fillore dhe një e mesme në komunën e Vitisë/Vitina, një shkollë fillore në komunën e Novobërdës/Novo Brdo, njëmbëdhjetë shkolla fillore dhe një shkollë e mesme në komunën e Kamenicës/Kamenica. Në komunën e Shtërpçës/Strpce të gjitha shkollat fillore (përveç njerës, në të cilën vijojnë mësimin nxënësit shqiptarë) si dhe shkolla e lartë janë nën mbikqyrjen e drejtpërdrejt të MSAS- it.<sup>59</sup>

Në rajonin e Prizrenit, e vetmja komunë e cila ka struktura paralele ekzistuese është Rahoveci/Orahovac, me dy shkolla fillore dhe një të mesme.

Në rajonin e Pejës/Pec shkolla fillore e cila gjindet në Osojan/Osojane - në komunën e Istogut/Istok, si dhe shkolla fillore dhe e mesme në Gorazhdevc/Gorazhdevac, të gjitha këto janë nën mbikqyrjen e MSAS- it

Universiteti serb në pjesën veriore të Mitrovicës/Mitrovica është duke operuar nën rregullat e Serbisë që nga përfundimi i konfliktit. Të gjitha universitetet të cilat funksionojnë në Kosovë që nga viti 2001 kanë qenë të legalizuara kur është shpallur në fuqi Ligji mbi arsimimin e

<sup>58</sup> Lexo 4.2.1.3 në vijim për hollësi të mëtutjeshme lidhur me rrogat e dyfishta të cilat i marrin mësuesit serb të Kosovës.

<sup>59</sup> Shkolla e mesme i ka dy drejtorë: njëri i emëruar nga ministria e Serbisë ndërsa tjetri nga ministria e Kosovës për arsim. Të dytë pohojnë se ka bashkëpunim të mirë dhe te dytë punojnë sipas orarit serbë. MSAS dhe MASHT i paguajnë rrogën drejtorit të emëruar nga Beogradi, ndërkohë drejtori i emëruar nga MASHT paguhet vetëm nga BKK. I pari i raporton MSAS ndërsa i dyti MASHT.

lartë nga ana e PSSP më 12 maj të vitit 2003<sup>60</sup>. Edhe përkundër këtij ligji, dy studentë serb nga Universiteti i Mitrovicës/Mitrovica nuk ishin pranuar në programin veror të shkollës së Universitetit të Mitrovicës/Mitrovica. Sipas një anëtarit të komisionit për selektimin e pjesëmarrësve, këta studentë nuk i kishin notat që kërkoheshin dhe këta e kishin dorëzuar dokumentacionin e rrejtshëm (në dokumentet e tyre shkruante Universiteti i Prishtinës/Pristina në vend të Universiteti i Mitrovicës/Mitrovica<sup>61</sup>.

## 4.2 Shkaktarët dhe efektet e strukturave paralele

OSBE-ja ka bërë ekzaminime se cilat pengesa ekzistojnë në territorin e Kosovës dhe të Serbisë, dhe që e pengojnë punën e këtyre strukturave paralele administrative të arsimit të sipërpërmendur si dhe konsolidimin e të gjitha strukturave në një sistem të përbashkët të arsimit.

### 4.2.1 Shkaktarët kryesorë të strukturave paralele

#### 4.2.1.1 Perceptimi i mungesës së sigurisë

Mungesa e sigurisë vazhdon të jetë faktori kryesor në pretendimin e serbëve të Kosovës se ata nuk mund ta parashohin se do të bëhet integrimi i shkollave në një të ardhme të afërt. OSBE-ja, në mars të vitit 2003 ka ardhur në përfundim se incidentet serioze kundër pjestarëve të komunitetit serb si dhe minoriteteve tjera janë zvogëluar dukshëm në vitin e fundit.<sup>62</sup>

Sidoqoftë, situata e sigurisë është prishur gjatë këtyre muajve të fundit, dhe frika e kërcënimit, ngacmimit dhe provokimit vazhdon të jetë pjesë e jetës së përditshme për serbët e Kosovës.

Nxënësit serbë të Kosovës shpeshë udhëtojnë edhe jashtë komunave të tyre për t'i vijuar mësimet nëpër shkollat e mesme nëpër enklavat serbe, për shkak të ndjenjes se shkollat e përziera në komunat e tyre nuk janë edhe të sigurta. Dhe më tutje, për shkak të mungesës së transportit të sigurt ditor për nxënësit e minoriteteve, shumica e tyre duhet të udhëtojnë në fillim të javës dhe të sigurojnë diku strehim në atë komunë. OSBE-ja më parë kishte dokumentuar të metat e MASHS që të sigurojë autobusin transportues të sigurt nga enklavat për nxënësit e minoriteteve në baza më të qëndrueshme.<sup>63</sup>

#### 4.2.1.2 Qëndrimet e barrikaduara të një pjese të komunitetit të shqiptarëve të Kosovës dhe atij të serbëve të Kosovës kundrejt tolerancës dhe gjetjes së një baze të përbashkët

Gjatë periudhës pas konfliktit, nuk ka pasur ndonjë shenjë e tolerancës ose tentimeve që të gjindet një bazë në mes të komunitetit shqiptar dhe serb sa i përket konsolidimit të sistemit arsimor. Për shembull, anëtarët e komunitetit serb në komunën e Pejës kur janë pyetur nëse do të ishte e dobishme në të ardhmen që fëmijët e tyre ta mësojnë gjuhën shqipe, ka qenë përgjigje e thjeshtë se nuk u nevojitet ta mëlojnë për arsye se ata jetojnë në Serbi. Më tutje, kur MASHS ka kërkuar nga dhe kishte tentuar që t'i kurajoj serbët e Kosovës që të konkurrojnë për drejtor të shkollës nëpërmjet konkursit të tyre në gjuhën serbe, vetëm një

<sup>60</sup> Rreg. e UNMIK-ur 2003/14 mbi shpalljen në fuqi të Ligjit mbi arsimin e lartë në Kosovë të miratuar nga Kuvendi i Kosovës. Kjo Rregullore parashikon që “varësisht nga veprimi që kërkohet nga Kuvendi i Kosovës që të sigurojë se Ligji mbi arsimin e lartë në Kosovë të mbulojë në mënyrë adekuate të drejtat e të gjitha komuniteteve për shkollim të lartë, ky Ligj përkohësisht do të plotësohet me një nen të ri 10.8 i cili reflekton rekomandimin e vendimit të kolegjit special, i cili thotë: “të gjithë shërbyesit e arsimit të lartë të cilët janë të autorizuar të operojnë gjatë vitit akademik 2001-2002, do të licencohen sipas këtij ligji dhe në pajtim me të gjitha parimet ndërkombëtare kundër diskriminimit gjatë punës së tyre për t'i plotësuar standardet e përcaktuara me ligj”.

<sup>61</sup> Lexo gjithashtu kumtesën për shtyp të Këshillit për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të njeriut me 23 korrik 2003 të botuar në Koha Ditore.

<sup>62</sup> Lexo raportin e përbashkët të OSBE-UNHCR “Vlerësimi i dhjetë i gjendjes së pakicave etnike në Kosovë, mars 2003, f. 12

<sup>63</sup> Lexo Raportin javor të Departamentit për të drejta të njeriut dhe sundim të së drejtës, 5 –11 maj 2003.

numër i vogël i aplikacioneve ishte pranuar, edhe përkundër nivelit të ulët të papunësisë së komunitetit serb të Kosovës.<sup>64</sup>

Përkundër faktit se sigurimi i minoriteteve shpesh deklarohet nga ana e komunitetit ndërkombëtar këtu në Kosovë si një kusht paraprak për rregullimin përfundimtar politik, as MASHS e as autoritetet arsimore nëpër komuna nuk kishin paraqitur plan gjithëpërfshirës i cili do të siguronte integrimin e minoriteteve në përgjithësi, ose anëtarët e komunitetit serb të Kosovës në veçanti në sistemin arsimor të MASHS.

Çështjet si e drejta për ta mësuar gjuhën e nënës, e drejta për të studiuar temat e ndyshme në gjuhën e nënës si dhe mësimi i historisë janë tema të cilat ende nuk janë çasur nga arsimtarët shqiptar dhe ata serbë të Kosovës nëpër të gjitha nivelet e arsimit. Autoritetet arsimore e kanë informuar OSBE- në se kanë probleme me tekstet- librat e historisë, të cilat janë përdorur nëpër shkollat e Kosovës për shkak të verzionit të historisë të cilën e përshkruajnë<sup>65</sup>.

Në fund, ku janë bërë përpjekjet nga ana e arsimtarëve shqiptarë dhe serb në nivelet lokale për të inicuar diskutimet se si mundën ata që të kombinojnë përpjekjet e tyre në mënyrë që të konsolidojnë sistemet paralele të arsimit, këto tentime zakonisht dështojnë për shkak të qëndrimeve që nuk janë të pajtueshme nga ana e zrtarëve të lartë. Për shembull, në Gjilan zyrtarët arsimor si ata shqiptarë, ashtu edhe ata serbë vazhdimisht theksojnë se përderisa ata kishin tentuar të bashkëpunojnë, ata kishin dështuar të bëjnë marrëveshje për shkak se atyre iu ndalohe nga ana e MASHT dhe MSAS. Zyrtarët kishin theksuar se është e rëndësishme bashkëpunimit të mbi çështjet si pagat, programet mësimore, si dhe se është përgjegjësi për arsimimin në përgjithësi.

#### *4.2.1.3 Pagat e dyfishta të ofruara për arsimtarët serbë*

Rrogat që iu paguhen arsimtarëve serbë të Kosovës janë gati dy herë më të mëdha se sa mesatarja e rrogave në Serbi. MASHT thekson se qëllimi i këtyre pagave aq të mëdha është që t'i kompensojë arsimtarët serbë të Kosovës dhe që t'i kurajoj ata që të rrinë në pozitë e tyre. Arsimtarët serbë gjithashtu pranojnë pagat nga MASHT. Efekti është i atillë që arsimtarët shqiptarë e cilët punojnë nën MASHT fitojnë nga 200 Euro për muaj, përderisa arsimtarët serbë fitojnë edhe nga MASHT edhe nga MSAS, dhe ata i fitojnë më shumë se 500 euro në muaj. Në anën tjetër, nëse arsimtari serb i Kosovës hetohet se ka kontratë me MASHT të Kosovës, atij i reduktohet paga për 50 %.<sup>66</sup>

OSBE- ja ka pranuar disa ankesa individuale nga arsimtarët serbë të Kosovës në Mitrovicë/Mitrovica, për shkak të vendimit të drejtorëve të shkollave për t'i hequr prej listave të rrogave ata arsimtarë që janë me kontratë të nënshkruar me MASHT. Kur OSBE- ja kishte takuar zyrtarin rajonal të UNMIK- ut për arsim, ai iu kishte spjeguar se arsimtarët paguhen nga ana e MASHT sipas listave të cilat janë dorëzuar nga ana e drejtorëve, por MASHT nuk mirret me ato çështje se cilët persona duhet të jenë në ato lista. MASHT duhet të mbështetet në MSASH në mënyrë që të konfirmojë se a janë të sakta listat e personave që duhet të

<sup>64</sup> Për të inkurajuar kandidatët potencial nga grupet e pakicave që të aplikojnë për vende të punës, MASHT i bën shpalljet nëpër mediat në gjuhë të pakicave dhe kërkon shërbimet e ZLK të UNMIK-ut për t'i shpërndarë ato.

<sup>65</sup> Për shembull, komuniteti turk në Mitrovicë/Mitrovica është ankuar se libri i tanishëm i historisë në përdorim nëpër shkollat në jug të Mitrovicës/Mitrovica, e trajton komunitetin turk me përbuzje për shkak të fotografive në të cilat kali e shkelë flamurin turk. Janë ndërmarrë masa nga MASHT për rregullimin e kësaj çështjeje.

<sup>66</sup> Për shembull, mësuesi serb i Kosovës e merr rrogën në shumën prej 300 eurosh nga MSAS (dy herë më e madhe se sa rroga e mësuesit në Serbi). Krahas kësaj, një rrogë paguhet edhe nga MSHAT ( sipas të ashtuquajturës kontratë "B" e cila paguan përafërsisht 140 euro, dhe e cila parashikon të ardhura më të ulta krahasuar me mësuesit shqiptarë të Kosovës të cilët e kanë kontratën "A" e cila është përafërsisht 200 euro). Më pas, rroga e MSAS prej 300 euro, mund të ulet deri në 150 euro nga MSAS nëse mësuesi serb i Kosovës e nënshkruan kontratën "B" me MASHT. Në fund del se mësuesit serb paguhen përafërsisht 290 euro në muaj nga të dy kontratat ndërsa mësuesit shqiptarë të Kosovës paguhen përafërsisht 200 euro në muaj.

paguhen nga ana e MASHT. Megjithatë arsimtarët ankohen, sepse ata konsiderojnë se ata janë hequr në mënyrë arbitrare nga listat nga ana e MASHT, p. sh. si dënim për mos përmbushjen e detyrave.

MASHT ka ardhur në përfundim se ekziston një tepricë e arsimtarëve dhe e punëtorëve administrativ në shkollat serbe të Kosovës, dhe përderisa nuk e kanë reduktuar numrin e personelit të cilët do të paguhen për shërbimet e tyre të dhëna në procesin arsimor, MASHT- i ka futur në ndalesë për rekrutimin e arsimtarëve serbë të Kosovës si dhe të personelit që nuk japin mësim.<sup>67</sup>

#### **4.2.2 Efektet e strukturave paralele**

##### **4.2.2.1 Programet e ndryshme**

Për shkak se MASHT dhe MSASH nuk kanë bërë marrëveshje për planprogramet shkollore për Kosovë, nxënësit ballafaqohen me programet dalluese varësisht se në cilin sistem ata zgjedhin t'i përcjellin mësimet. Këto dallime mund të përcaktojnë se a munden nxënësit t'i gëzojnë të drejtat e tyre që të mësojnë në gjuhën amtare, që të mësojnë në lëndët përkatëse në gjuhën amtare, si dhe të mësojnë për historinë dhe kulturën e grupeve të tyre etnike. Në veçanti prindërit e nxënësve serbë janë të brengosur për arsye se fëmijët e tyre mund të nxiten që të mësojnë, sa për përceptimin e tyre, historinë dhe gjeografinë e shtrembuar nëpër shkollat e përziera të cilat udhëhiqen nga ana e MASHT.

Diplomat dhe qertifikatat e shqiptarëve të Kosovës të shkollave fillore dhe të mesme nuk njihen nga ana e MSASH. P. sh. në pjesën veriore të Mitrovicës, kordinatori serb për arsimim kishte kërkuar ndihmë nga OSBE- ja sa i përket një grupi të nxënësve boshnjakë nga Prizreni të cilët kishin dashur që të vazhdojnë me mësim në pjesën veriore të Mitrovicës. Në këtë shkallë ata nuk mund ta bëjnë këtë. Nxënësve u kërkohet që të kenë qertifikatat serbe të shkollës fillore, sepse MSASH e kërkonë këtë. MSASH argumenton se nëse i pranon këto planprograme të MASHT të Kosovës, nxënësit serbë të Kosovës të cilët janë persona të zhvendosur nuk do të kthehen në Kosovë. Edhe për më tepër, MSASH deklaroi se ata e kanë planprogramin e tyre në mënyrë që të garantojnë që serbët e Kosovës dhe nxënësit tjerë të minoriteteve nga Kosova do të jenë të kualifikuar që të këtkojnë arsimim më të lartë në territorin e Serbisë.

##### **4.2.2.2 Fëmijët janë zënë pengje në këtë betejë politike**

Kualiteti i arsimit mund jetë i ndikuar, për shkak se MSASH nuk mund të ketë kontrollë. Për shembull, në Kamenicë/Kamenica gjatë vitit të tanishëm shkollor, MASH kishte kërkuar që drejtori i tanishëm serb të ndërrohet. Ishte dhënë konkursi për vend pune, por shumë pak kishin konkurruar. Sidoqoftë, drejtori i mëparshëm e kishte anuluar procesin e rekrutimit, dhe se ai vazhdon të punojë si drejtor i shkollës. Në një shembull tjetër, një arsimtar serb i gjuhës ruse, i cili ishte paguar që të japë mësim për dy klasë, njëra klasë në shkallën e i- rë dhe rtjetra në të II- të, i kishte bashkuar që të dyja klasët për mësim. Kështu ai i mësonte nxënësit e njerës klasë të cilët ishin në një shkallë të profilit më të ulët dhe të moshës së ndryshme, dhe kështu ai ishte paguar me rrogë se ai i mëson dy klasët.

Kualiteti i arsimit ndikohet gjithashtu për shkak të mungesës së trajnimeve për arsimtarët serbë të Kosovës. Pas kërkesës së MSAS, UNMIK-u ka organizuar programe trajnuese për mësues/drejtorë për serbët e Kosovës me ndihmën e UNICEF-it dhe Projektit të zhvillimit të

---

<sup>67</sup> Në Graçanicë/Gračanica/, drejtorët e shkollave serbe të Kosovës i emërojnë mësuesit pa konsultim paraprak me MASHT ose duke mos i përfillur procedurat e caktuara nga MASHT. Pas emërimit dërgohen emrat e personelit te zyra komunale për arsim në Graçanicë/Gračanica/ që të inkuadrohen mësuesit e ri në listën e pagave të drejtorisë komunale për arsim. Mirëpo, përgjigjja e drejtorisë është shpeshherë negative për shkak se ata nuk janë konsultuar para marrjes së vendimeve dhe se procedura nuk është respektuar.

arsimit në Kosovë, një organizatë kanadeze. Janë ofruar trajnimet e vazhdueshme profesionale për mësuesit shqiptarë të Kosovës nga ana e MASHT.

Dhe si rezultat i asaj se çka është bërë traditë e urrejtjes etnike, fëmijët janë bërë pengje të betejës politike të pas luftës në mes grupeve etnike. Nëse këto grupe nuk mund të gjejnë baza të përbashkëta ose së paku një koekzistencë në mes njeri- tjetrit, fëmijët e tyre do të jenë ata të cilët do ta paguajnë çmimin. Për më tutje, kur të mirremi me këto çështje, si prindërit, ashtu edhe autoritetet i kushtojnë kujdes të vogël për faktin se e drejta për arsimim është e drejta e fëmijëve e jo e prindërve.

*Kapitulli i pestë*

**SISTEMI SHËNDETËSOR PARALEL**

## 5.1 Strukturat

Pasiqë serbët e Kosovës kanë përjetuar kufizime të lëvizjes së lirë pas konfliktit në Kosovë dhe pas mosbesimit të dyanshëm në mes të shqiptarëve dhe serbëve, ata kishin zhvilluar sistemin paralel të kujdesit shëndetësor. Përveç sistemit të kujdesit shëndetësor që udhëhiqet nga IPV-es, OSBE-ja kishte identifikuar disa objekte shëndetësore të cilat udhëhiqen nga Ministria serbe e Shëndetësisë. MSSH e mbikqyrë dhe i paguan punëtorët si dhe i mbulon të gjitha hargjimet tjera të nevojshme. OSBE-ja kishte identifikuar gjithashtu edhe objektet tjera, të cilat pjesërisht janë duke u paguar nga MSSH dhe pjesërisht nga IPV/Ministria e Shëndetësisë. Si përmbledhje e këtyre strukturave “gjysëm paralele”, përcillen edhe objektet tjera që udhëhiqen nga MSSH.

Në rajonin e Mitrovicës/Mitrovica, të gjitha objektet e kujdesit shëndetësor të cilat gjenden në Zubin Potok, Leposaviq/Leposavic, Zveçan/Zvecan dhe në pjesën veriore të Mitrovicës/Mitrocia, janë drejtpërdrejt nën mbikqyrjen e autoriteteve të MSSH. E njëjta gjë zbatohet edhe në stacionin shëndetësor në Prilluzhë/Priluzje (enklava më e madhe serbe në komunën e Vushtrrisë/Vucitrn), dy ambulanta të cilat gjenden në Gojbullë/Gojbulja (komuna e Vushtrrisë/Vucitrn) dhe në Gracë/Gracka si dhe ambulanta e cila gjendet në Suhagërl/Suho Grlo (komuna e Skenderajt/Serbica) duke shërbyer dy fshatra të Banjës/Banjaska dhe të Suhagërl/Suvo Grlo.

Në rajonin e Prishtinës/Pristina, objektet vijuese janë nën mbikqyrjen e drejtpërdrejt të MSSH: në komunën e Prishtinës/Pristina stacioni shëndetësor në Graçanicë/Gracanica dhe ambulatat që gjenden në Bërnice të Poshtme/Donja Brnica, Çagllavicë/Çaglavica, Sushicë/Susice, Llapnasellë/Lapje Selo dhe në Preocë/Preoce. Në komunën e Fushë Kosovës/Kosovo Polje objekti shëndetësor i cili gjendet në Bresje, e cila e furnizon dhe e udhëheqë ambulantën në Batushë/Batuse si dhe një ambulante të vogël në programin e ndërtesave YU në Prishtinë/Pristina. Në komunën e Lipjanit/Lipljan shtëpia e shëndetit në Gushtericë të Ultë/Donja Gusterica, e cila i furnizon dhe e kordinon punën në qytetin e Lipjanit/Lipljan, në Gushtericë të Epërme/Gornja Gusterica, Rubofc/Rubovac, Suvidoll/Suvi Do, Lepinë/Lepinje, Grackë/Grace, Dobrotin, dhe Novonasiljë/Novonasilje. Në komunën e Obiliqit/Obilic, ambulanta në Plemetin/Plemetine si dhe dy ambulanta në qytetin e Obiliqit/Obilic dhe në Cërkvëna Vodice/Crkevena Vodica.

Gjilani/Gnjilane është i vetmi rajon në të cilin janë prezente strukturat gjysëm-paralele. Të gjithë punëtorët shëndetësor, pranojnë të ardhurat nga MSSH dhe IPV/Ministria e Shëndetësisë, dhe këto janë nën mbikqyrjen MSSH. Në katër shtëpi serbe të shëndetit të cilat gjenden në komunën e Gjilanit/Gnjilane (Pasjanë/Pasjane, Budrigë e Ulët/Donja Budriga, Kusicë e Epërme/Gornje Kusce, Koretishtë/Koretiste), si mjekët, ashtu edhe motrat medicinale marrin të ardhurat e dyfishta.

Në komunën e Vitisë/Vitina dy shtëpi serbe të shëndetit janë nën mbikqyrje të drejtpërdrejt të MSSH. Seksioni shëndetësor në komunën e Shtërpçës/Strpce i punëson 294 punëtorë. MSSH i paguan rrogat e tyre. 114 punëtorë i marrin pagat edhe nga IPV/Ministria e Shëndetësisë. Në komunën e Kamenicës/Kamenica, mjekët dhe motrat medicinale që punojnë në shtëpinë serbe të shëndetit dhe nëpër ambulanta, të cilat gjenden në Rapotovë të Madhe/Veliko Raptovo, Kamenicë/Kamenica, Kormjani i Epërm/Gornje Korminjane, Domorovc/Domorovce, Kollolec/Kololec, Boscë/Bosce, Hajnofc/Ajnovce dhe Bozhevc/Bozevce, i marrin pagat e dyfishta.

Në rajonin e Prizrenit, nga ana e OSBE- së nuk janë identifikuar asnjë strukturë paralele ose gjysëm paralele. Mirëpo, disa pjesëtarë të komunitetit serb të Kosovës, përveç në rastet emergjente, ndihen më të sigurtë që të udhëtojnë ose për në Mitrovicë/Mitrovica ose për në Graçanicë/Gracanica, se sa t'i shfrytëzojnë shërbimet shëndetësore në kuadër të regjionit.

Në rajonin e Pejës/Pec, personeli mjekësor i cili punon në stacionin shëndetësor në Gorazhevc/Gorazdevac (komuna e Pejës/Pec) i marrin pagat e dyfishta, nga MSSH dhe nga IPV/Ministria e shëndetësisë (e Kosovës). Të dyja ministritë bashkërisht e kryejnë funksionin e mbikqyrjes. Në Osojanë/Osojane (komuna e Istogut/Istok), pesë motra medicinale dhe një mjek ofrojnë shërbimet e mjekësisë primare për popullatën e asaj ane. Njëra nga motrat është në listat e rrogave që paguhen nga ana e Ministrisë së Shëndetësisë së Kosovës, ndërsa katër tjerat paguhen nga ana e MSSH.

## 5.2 Shkaqet dhe efektet e struktave

OSBE-ja ka vërejtur se ka pengesa në territorin e Serbisë dhe të Kosovës, dhe që parandalojnë shkrirjen e strukturave administrative në shëndetësi dhe konsolidimin e këtyre strukturave në një strukturë të përbashkët.

### 5.2.1 Shkaqet themelore të qendrave paralele të shëndetësisë

#### 5.2.1.1 Qëndrimet e barrikaduara të një pjese të komunitetit të shqiptarëve të Kosovës dhe atij të serbëve të Kosovës kundrejt tolerancës dhe gjetjes së një baze të përbashkët

Ekziston një paragjykim i përgjithshëm në mesin e serbëve të Kosovës se profesionistët shëndetësor shqiptarë të Kosovës nuk e kanë të njejtën shkallë të aftësive profesionale sikur që e kanë profesionistët serbë të shëndetësisë. Të njejtat brenga janë paraqitur edhe nga komuniteti shqiptar sa i përket profesionistëve serbë të shëndetësisë. Si shtesë, disa serbë mendojnë se ata mund të jenë viktimat e trajtimit të dobët nga ana e personelit mjekësor shqiptar si një formë e hakmarrjes për të kaluarën, kështu ndodhë edhe për palën e kundërt.

Sipas Ministrisë së Shëndetësisë, nuk ka ndonjë shenjë të tolerancës si dhe dëshirës për të gjetur baza të përbashkëta në mes të komunitetit shqiptar dhe atij serb sa i përket shëndetësisë.<sup>68</sup> Ky dështim për të komunikuar dhe për ta zgjedhur problemin është një shenjë e konfliktit të thellë në mes të komuniteteve shqiptarëve dhe serbëve të Kosovës dhe se mund të vështirësohet edhe më shumë sepse shëndetësia është një çështje e jetës apo vdekjes.<sup>69</sup>

#### 5.2.1.2 Rrogat e dyfishta të paguara nga Ministria serbe e shëndetësisë

Sikur në strukturat paralele të arsimit, pagesa e rrogave të dyfishta<sup>70</sup> nga ana e MSSH për punëtorët e saj në Kosovë shërben për t'i forcuar strukturat paralele administrative. MSSH i jepë arsyetimet e saja për rrogat e dyfishta siç janë caktuar nga Ministria serbe për arsimim dhe për sport sa i përket arsimimit, për shembull, nevoja për ta paguar personelin mjekësor me rroga më të mëdha në mënyrë që t'i motivojnë ata që të vazhdojnë të punojnë në Kosovë. Përderisa ky problem nuk është edhe aq i theksuar në rastin e arsimit, ky mund të jetë ende problem në mes të Ministrisë së Shëndetësisë dhe punëtorëve të Ministrisë serbe të shëndetësisë.<sup>71</sup> Gjishtashtu MSSH pohon se është me rëndësi që të mbajnë më shumë

<sup>68</sup> Për shembull, marrëveshja ndërmjet MSSH dhe Ministrisë së Shëndetësisë së Kosovës mbi planin për shtëpinë e shëndetit në Lipjan/Lipljan, që t'ju shërbejë dy palëve, serbëve të Kosovës dhe shqiptarëve të Kosovës, gjithashtu edhe minoriteteve tjera, ka dështuar për shkak se IPV-es/Ministria e Shëndetësisë ka propozuar 24 vende pune për serbët e Kosovës, ndërsa që ata më parë i kishin 96 të punësuar serbë të Kosovës në listat e pagave. Përpjekjet e IPV-es Ministrisë së Shëndetësisë të Kosovës për ta përshtatur sistemin shëndetësor të Kosovës me ekonominë e tregut nuk aprovohet nga Beogradi. Më shumë në faqen 39.

<sup>69</sup> Për shembull, në Gorazhevc/Gorazdevac, ka vetëm një mjek, një dentist dhe katër motra medicinale të cilët i mbulojnë nevojat mjekësore dhe dentale për tërë katundin. Nëse fshatarët kanë nevojë për trajtim mjekësor në një spital tjetër, ata nuk drejtohen në spitalin e Pejës/Pec, por ata më parë shkojnë në spitalin në veri të Mitrovicës/Mitrovica ose në Serbi.

<sup>70</sup> Në këtë rast fjalët "rogë e dyfishtë" i referohen praktikës së MSSH për të paguar dyfishin e rrogës së punëtorit shëndetësor në Kosovë njësoj sikurse e paguajnë rrogën e personit me kualifikime të njëjta në Serbi.

<sup>71</sup> Për shembull, drejtori i shëndetësisë (i punësuar nga MSSH) në Fushë Kosovë/Kosovo Polje ka deklaruar se një specialist i cili punon në ambulancën serbe në Bresje/Bresje mund të paguhet deri në 760 euro në muaj, ndërsa specialisti në Fushë Kosovë/Kosovo Polje i cili paguhet nga IPV-es fiton 210 euro në muaj.



punëtorë shëndetësor se sa duhen për shkak të mungesës së punësimit të personelit mjekësor serb nëpër objektet shëndetësore të Kosovës.

### **5.2.2 Efektet e qentrave paralele të shëndetësisë**

Objektet shëndetësore të cilat udhëhiqen nga MSSH, nuk mbikqyren në baza ditore nga Beogradi. Kjo mund të shpiejë deri te keqpërdorimi i burimeve financiare, të cilat janë të ndara nga MSSH për objektet e veçanta të shëndetësisë<sup>72</sup>. Mungesa e mbikqyrjes mundet që edhe më shumë të rezultojë në objektet e rëndomta të punësuar, siç është rasti me ambulatat të cilat udhëhiqen nga MSSH, të cilat janë themeluar në shtëpitë private nëpër enklava.<sup>73</sup>

Një problem tjetër është se personeli i profesionalizuar mjekësor nëpër objektet mjekësore shqiptare dhe serbe të Kosovës kanë shumë pak mundësi për të këmbyer informata dhe për të dhënë ekspertiza për çështjet të cilat kanë të bëjnë me mjekësi. Për shembull, mjekët në të dyja sistemet nuk kanë mundësi që të konsultohen në mënyrë të përshtatshme me njeri tjetrin si dhe të këmbëjnë informata profesionale për çështjet që kanë të bëjnë me diagnostifikim dhe me trajtim.

Punëtorët serbë të shëndetësisë nuk kanë gjithnjë çasje të lehtë në territorin e Serbisë për të qenë në mundësi që të përcjellin ligjëratat në arsimimin mjekësor, të cilat mund të ofrohen nga MSSH. As që mundet personeli që të përcjellë ligjëratat në objektet shqiptare të shëndetësisë. Sipas Ministrisë së Shëndetësisë, Ministria ka tentuar që të mbajnë ligjëratat e vazhdueshme mjekësore, por MSSH nuk e ka aprovuar formalisht një bashkëpunim të tillë. Nganjëherë Ministria e Shëndetësisë kishte ofruar që të paguaj për shpenzimet e rrugës, ushqimit akomodimit në raste të konferencave ndërkombëtare për arsimimin mjekësor, por ende nuk kanë marrë pjesë mjekët serbë në to.<sup>74</sup>

Përderisa spitalet e MSSH dhe shtëpitë e shëndetit kanë një numër të madh të personelit, objektet e UNMIK- ut kërkojnë që të përputhen me parimet ekonomike që të themelojnë koston efektive që të përcaktojnë sa persona duhet të punësohen në institucionet përkatëse si dhe në çfarë shkalle duhet të jetë ajo. Dhe më tutje, UNMIK- u tenton që të zbatojë masat për veprim afirmativ që të sigurojë balansin etnik me personel në secilin objekt. Kombinimi i zvogëlimit të numrit si dhe zbatimi i masave për të bërë balansin e përfaqësimit etnik nëpër objektet shëndetësore që udhëhiqen nga serbët mund të shpiejë në rezultate shumë dëshpëruese. Në veçanti, kjo mund të shpie në diskriminimin indirekt të personelit mjekësor serb të cilët i kanë humbur punat e tyre dhe të cilët nuk kanë çasje për tu punësuar nëpër objektet tjera shëndetësore në Kosovë për arsye të kufizimit të lirisë së lëvizjes<sup>75</sup>. Por, për ta zbutur problemin pjesërisht, duhet të kihet parasysh se, në rastet e veçanta, pozitat të cilat janë të rezervuara për serbët e Kosovës nuk janë të plotësuara siç ishte rasti në Fushë Kosovë/Kosovo Polje, ku 53 vende pune të cilat ishin hapur nga UNMIK- u në shtëpinë vendore shëndetësore, vetëm pesë konkuroes ishin pranuar.

<sup>72</sup> Për shembull, spitali në veriun e Mitrovicës/Mitrovica, në listën e pagave ka pasur më shumë njerëz të sigurimit se sa që në të vërtetë ishin të punësuar nga spitale. Lexo faqe 12-13.

<sup>73</sup> Për shembull, ambulanta në Plementin/Plementin është vendosur në një shtëpi private e cila nuk i plotëson kushtet për udhëheqjen e një objekti të tillë shëndetësor.

<sup>74</sup> Asnjë nga mjekët dhe motrat medicinale në katër ambulatat e udhëhequra nga MSSH në Gjilan/Gnjilane nuk kanë marrë pjesë në kurset ose mbledhjet e anëtarëve të sektorit të shëndetësisë të mbajtur nga IPV/Ministria e Shëndetësisë.

<sup>75</sup> Politikat e zvogëlimit të numrit të punëtorëve nuk aprovohen nga objektet serbe. Në rastin e ambulantës në Bresje/Bresje, për shembull, IPV/Ministria e Shëndetësisë është përpjekur të inkurajojë zvogëlimin e numrit të 187 të punësuarve serbë për të arritur një përfaqësim më të mirë shumetnik. Kjo nuk u pranua nga ata. Pastaj, ata nuk janë përfshirë në listën komunale të pagave. Mirëpo, ky personel ende i merr rrogat nga MSSH të cilat janë në masë të konsiderueshme më të mëdha se sa ato që ofrohen nga IPV-es.

*Kapitulli i gjashtë*

**MINISTRIA SERBE E PUNËVE TË BRENDËSHME  
LËSHIMI I PATENTË SHOFERIT DHE DOKUMENTEVE TJERA**

## 6.1 Strukturat

Shumë zyre të Ministrisë së Punëve të Brendshme të Serbisë janë të vendosura në tërë territorin e Kosovës (MPB)<sup>76</sup>. Këto janë zyre të sekretariatit të MPB të SPB<sup>77</sup>. Operativa e tyre përfshinë administrimin dhe dhënien e pasaportave, patentët e shoferëve, letërnjoftimet si dhe tabelat e regjistrimit të automjeteve. Shumë kosovarë janë drejtuar në këto zyre, posaçërisht ata të cilët kanë nevojë të udhëtojnë në territorin e Serbisë, pasi që dokumentacioni i lëshuar nga ana e UNMIK- ut nuk trajtohet fare atje.

OSBE- ja ka mësuar se disa zyre të SPB- së janë të vendosura në Kosovë. Në rajonin e Mitrovicës/Mitrovica gjinden disa zyre të SPB- së në Zveçan/Zvecane si dhe në vet Mitrovicë/Mitrovica. Në rajonin e Prishtinës/Pristina në këto vende në vijim mund të gjinden zyret e MPB- së: Graçanicë/Gracanica, Fushë Kosovë/Kosovo Polje, Gushtericë e Ultë/Donje Gusterica (komuna e Lipjanit/Lipljan); Plementin si dhe në afërsi të ish- KFOR- it norvegjez i bazuar jashtë Prishtinës/Pristina. Në Shtërpcë/Strpce gjithashtu gjindet një zyre e cila deri vonë ishte vendosur në objektin e Kuvendit Komunal.

OSBE- ja nuk ka qenë e nohur se a i kanë autoritetet serbe këto zyre të lartpërmendura në këto lokacione si zyre të përherëshme si dhe a kanë orar të rregullt pune, as që ka qenë e mundur që të përcaktojnë në mënyrë precize kompetencat e tyre. Deri tani mund të thuhet se zyra në afërsi të ish- objektit të KFOR- it norvegjez ishte marrë me dhënien e pasaportave, zyra në Graçanicë kishte lëshuar letërnjoftimet, patentë shoferët, qertifikatat e lindjes si dhe dokumentet tjera. Zyra në Fushë Kosovë mund të konsiderohet si nën-zyre e asaj të Graçanicës/Gracanica.

Kemi gjithashtu edhe zyre të MPB- së të cilat gjinden në Serbi, të cilat janë të hapura dhe të dedikuara për individët prej komunave të Kosovës. Për shembull, ekziston zyra e MPB- së së Prishtinës/Pristina e cila gjindet në Nish, ajo e Shterpces/Strpce në Bujanoc, ajo e Mitrovicës/Mitrovica në Kralevë.

## 6.2 Efekti i strukturës

Shumë individë vazhdojnë që t'i çasen zyreve në tërë territorin e Kosovës që t'i marrin doikumentat e Serbisë. UNMIK- u kishte filluar dhënien e patentë shoferëve në vitin 2002, si dhe regjistrimin e automjeteve pa pagesë për serbët e Kosovës. Gjatë këtij procesi tël dhënies/ lëshuarjes së këtyre dokumentave kishte kaluar një kohë relativisht e gjatë, por kjo ka qenë një zhvillim i qartë pozitiv. Megjithatë, kjo e adreson vetëmnjë pjesë të problemit. Përderisa patentët e shoferit dhe regjistrimet e automjeteve nga ana e UNMIK- ut nuk njihet nga ana e Serbisë, kosovarët të cilët duhet të udhëtojnë në Serbi ende duhet të shkojnë dhe kërkojnë këto dokumenta udhëtimi nga autoritetet e Serbisë. Me fjalë të tjera, atyre iu duhen dy palë të dokumentacioneve dhe të tabelave të regjistrimit, një palë të pranuar në Kosovë, dhe tjetra në Serbi.

OSBE- ja ka mësuar se kur iu lëshohen banorëve kosovarë patentët e shoferit në Serbi, zyrtarët serbë theksojnë në dokumenta se ato janë lëshuar në zyren e MPB- së në Kosovë. Për shembull, një individ nga Prishtina mund ta marrë një dokument në Nish, por autoritetet serbe në dokument do ta shkruajnë “MPB Prishtinë” e jo “MPB NISH”. Sipas kuptimeve që ka OSBE- ja, arsyeja për këtë qëndron se qeveria e Serbisë i cakton zyret e ndryshme nëpër komunat e Kosovës, edhe pse shumica e këtyre zyreve gjinden në Serbi.

---

<sup>76</sup> Ministria e Punëve të Brendshme.

<sup>77</sup> Sekretariati i Punëve të Brendshme.

Policia shpeshë i ndalojnë dhe i arrestojnë personat të cilët i posedojnë këto dokumente, ti lëshuara nga strukturat paralele në Kosovë dhe në Serbi pas 10 qershorit 1999. Poseduesëve të këtyre patentëve të cilët vozisin në Kosovë iu shqiptohet akuza se mbajnë dokument jo të vlefshëm/ falso sipas Ligjit mbi bazat e sigurisë në komunikacion.<sup>78</sup> Rregullorja e UNMIK- ut 2001/29 mbi dokumentet që lejojnë lëvizjen e automjeteve në Kosovë si dhe çështjet tjera, thekson se personat lejohen që të lëvizin me automjete në Kosovë nëse ai/ ajo posedon “patentë shoferin e vlefshë të lëshuar nga ana e autoriteteve kompetente të RFJ- së”<sup>79</sup> Kjo është interpretuar nga komuniteti ligjor si kufizim i vlefshmërisë së autoriteteve kompetente të RFJ- së që gjenden jashtë Kosovës<sup>80</sup>. Situata është komplikuar me faktin se nuk është gjithnjë e mundur që të përcaktohet se a është lëshuar dokumenti mbrenda apo jashtë Kosovës.

Sidoqoftë, OSBE- ja ka hasur disa raste kur poseduesit e dokumentacionit të tillë kanë qenë të ndjekur dhe të dënuar për përdorimin e dokumentacionit fals. Dënimet e tilla janë ekzekutuar edhe kur personi i brengosur është sjellur mirë dhe pa ndonjë tentim mashtrimi. Falsifikimi i i dokumentacionit është vepër penale sipas nenit 203 të Ligjit Penal të KSAK, dhe i cili thekson se:

“(1) Kush falsifikon ndonjë dokument ose prodhun ndonjë dokument të vërtetë (origjinal) me qëllim që ai dokument të përdoret si dokument origjinal, ose kushdo që përdorë dokumentin e falsifikuar ose dokumentin e prodhuar si të vërtetë (origjinal), ose e posedon një dokument të tillë me qëllim që ta përdor atë si të vërtetë (origjinal), do të dënohet deri në tre vite burgim”

Paragrafi (3) i nenit 203 e rritë dënimin prej tre viteve deri në pesë vite për prodhim/ falsifikim të dokumentacionit, siç janë dokumentat publike (ku përfshihen patentë shoferët).

Ka qenë qëndrimi i OSBE- së se është e gabueshme ndjekja penale e këtyre poseduesëve të këtyre dokumentacioneve të falsifikuara, për arsye se këto dokumente nuk janë falsifikim i dokumentacionit origjinal”. Departamenti i Drejtësisë së UNMIK- ut (DOJ) ka poshtu të njëjtin qëndrim, dhe se problemi është adresuar në Qarkoren e drejtësisë 2003/ 1 (19 mars 2003) Mbi vlefshmërinë e patentë shoferëve të lëshuara nga autoritetet e RFJ- së. Kjo qarkore e qartëson qëndrimin e UNMIK- ut për vlefshmërinë e dokumentacioneve të lëshuara nga Republika e Serbisë ose të RFJ- së dhe se e qartëson se cilat dokumenta janë falsifikim. Sipas kësaj qarkoreje, “Një patentë e shoferit e lëshuar nga autoritetet e RFJ- së ose të Serbisë, edhe pse llogaritet si jo i vlefshëm nga UNMIK- u, nuk është i falsifikuar, dhe se nuk është e drejtë të akuzohet ndonjë person se ka bërë vepër penale të mbajtjes ose përdorimit të kësaj patente në kundërshtim me nenin 203”.<sup>81</sup>

Sipas kuptimeve që ka OSBE- ja, problemi i ndjekjes jo të rregullt penale për falsifikim, në një mënyrë është edhe i cunuar. Së voni, Gjykata Supreme e Kosovës ka anuluar një rast të Gjykatës së Qarkut të Gjilanit dhe se e ka kthyer rastin në gjykatën e shkallës së parë për t’u rigjykuar. Arsyeja ka qenë se Gjykata Komunale dhe ajo e Qarkut e ka ndjekur penalisht të pandehurin për falsifikim të dokumentacionit duke u bazuar në atë se patenta e shoferit ishte lëshuar nga MPB Vranje.

Gjykata Supreme kishte ardhur në përfundim se dëshmitë për falsifikim duhet të mblidhen dhe gjykimi duhet bërë duke u bazuar në ligj dhe në Qarkoren e drejtësisë 2003/1.<sup>82</sup>

<sup>78</sup> Gazeta Zyrtare e RSFJ 50/88, neni 183.1.

<sup>79</sup> Neni 1.1 (b).

<sup>80</sup> Neni 5.

<sup>81</sup> Neni 6 sqaron se në Kosovë, leja mund të konsiderohet e falsifikuar mbi bazën se është lëshuar nga autoritetet e FRJ-së ose ato serbe. Mirëpo, këto leje ende mund të konsiderohen të rrejshme sipas kritereve të parashikuara në këtë nen.

<sup>82</sup> Gjykata Supreme e Kosovës, Pk.nr. 24/2003, 27 qershor 2003.

Sipas dokumentit të përbashkët<sup>83</sup>, është përgatitur një protokol i hartuar në vitin 2002 në mes të UNMIK- ut dhe RFJ- së, mbi lëvizjen e automjeteve të regjistruara dhe për dokumentacionin e lëshuar për tabelat e regjistrimit.. Ky protokol ishte dashur që të sigurojë lirinë e lëvizjes së serbëve dhe malazezëve të cilët vijnë në Kosovë dhe *vice versa*, me njoihjen e përbashkët të tabelave të regjistrimit dhe të dokumentave. Ky protokol kurrë nuk ishte nënshkruar, por shihet se është bërë një përparim në kohën e fundit. Më 16 korrik 2003, është mbajtur një takim në mes të shtyllës së parë të UNMIK- ut (Policisë dhe Drejtësisë) dhe Qendrës për koordinim për Kosovë. Palët janë pajtuar për tekstin e hartimit të ri të protokolit sa i përket lirisë së lëvizjes së automjeteve me regjistrim të UNMIK- ut dhe të Serbisë, amandamentet e inkuorporuara që të njihen patentët e shoferëve në heshtje. Ky hartim i protokolit ende është i pazgjedhur dhe pret aprovimin nga qeveria e Serbisë. Përderisa të nuk njihen tabelat e regjistrimit të UNMIK- ut për automjete nga autoritetet serbe, liria e lëvizjes do të bëhet edhe më e vështirësuar, edhe kosovarëve të cilët kërkojnë që të udhëtojnë në Serbi iu duhen dy palë tabela të regjistrimit.

Në çdo rast, UNMIK- u duhet të informojë publikun mbi vlefshmërinë e dokumentave serbe. Shihet se publiku shpesh është i painformuar dhe se mbështetet në deklaratat që bëhen në shtyp, në mënyrë që ta dijnë vlefshmërinë e dokumentave të tyre. Për shembull, përcaktimi i vlefshmërisë së dokumentave të RFJ- së për regjistrimin e automjeteve është rregulluar pjesërisht me vendimin ekzekutiv. Tani rishtazi, vendimi ekzekutiv 2003/13 mbi regjistrimin e automjeteve private në Kosovë nga banorët e Kosovës parashikon disa përjashtime nga pagesat e caktuara për regjistrimin për herë të parë të automjeteve private në Kosovë, nëse automjeti i tillë vetëmse është i regjistruar nga autoritetet e FRJ-së. Ky është një zhvillim pozitiv, sepse e zgjeron grupin e njerëzve të cilët janë të përjashtuar nga pagesat e këtyre obligimeve. Mirëpo këto vendime ekzekutive ende nuk janë publikuar në Gazetën Zyrtare të Kosovës, dhe publiku nuk ka fare qasje në përmbajtjen e këtij vendimi.

---

<sup>83</sup> Lexo futnotën nr 18.

## PËRFUNDIM

Strukturat paralele ashtu siç janë elaboruar në këtë raport, vazhdojnë të ekzistojnë në disa fusha të sektorit publik. Ekzistimi i sistemeve paralele mund të shkojë në dëm të sundimit të ligjit. Vendimet dhe shërbimet e ofruara nga strukturat e udhëhequra nga Serbia kanë ndikim të drejtpërdrejtë në të drejtat dhe jetërat e individëve që jetojnë në Kosovë. Për shembull, disa kosovarë i nënshtrohen rrezikut të shkatërrimit të pronës së tyre për shkak se UNMIK-u nuk e njih lejen e ndërtimit që lëshohet nga autoriteti paralel. Kosovarët gabimisht paditen për posedim të dokumentacionit të rrejshëm kur ata i përdorin lejet e ngasjes së automjetit të cilat lëshohen nga autoritetet serbe në Kosovë.

Strukturat paralele janë çështje mjaft politike. Duke vazhduar të financojë këto struktura, qeveria e Serbisë vazhdon të ushtrojë kontrollë mbi këto pjesë të Ksoovës. Në të njëjtën kohë, të drejtat dhe interesat e individëve vazhdojnë të ndikohen përmes refuzimit të vazhdueshëm të UNMIK-ut të njehë vendimet e lëshuara nga strukturat paralele. Kjo ngecje mund të tejkalohet vetëm përmes një marrëveshjeje politike në mes të UNMIK-ut dhe autoriteteve të Serbisë.

Mirëpo, janë bërë përpjekje nga të dyja palët që t'i tejkalojnë këto vështirësi. Si arritje mund të konsiderohet nënshkrimi i "Deklaratës së përbashkët për rekrutimin e gjyqtarëve dhe prokurorëve të përkatësisë etnike Serbe në kuadër të sistemit shumëtnik të Kosovës" nga ministri i Drejtësisë të Republikës së Serbisë dhe zëvendësi i PSSP-së për polici dhe drejtësi i UNMIK-ut. Deklarata e përbashkët e ka lehtësuar rekrutimin e prokurorëve dhe gjyqtarëve serb të Kosovës nëpër gjykatat e UNMIK-ut në komunat veriore të Kosovës. Kjo mund të shërbejë si model për sferat tjera publike, ku duhet ndërmarrë masa për të shpërndarë institucionet paralele.

Nga UNMIK-u nevojitet një qasje më pragmatike e cila mund të sjellë deri te njohja e faktit se disa kosovarë, në të kaluarën, s'kanë pasur rrugëdalje tjetër të arsyeshme përveq që t'ju drejtohen strukturave të udhëhequra nga Serbia. Procedura para gjykatës së UNMIK-ut ose organit administrativ do të nënkuptonte hyrje në rrezik për sigurinë personale, krahas shpenzimeve shtesë dhe situatës së pavolitshme. Vendimi se vendimet gjyqësore të gjykatave serbe dhe organeve administrative janë të pavlefshme mund të ndikojë negativisht në interesat e atyre të cilët, ndoshta me arsye, kanë prezumuar se këto vendime kanë fuqi ligjore në Kosovë. Për këtë arsye UNMIK-u duhet t'i konsiderojë këto vendime si juridikisht të vlefshme.

UNMIK duhet të merrë qëndrim lidhur me vlefshmërinë juridike të vendimeve dhe aktgjykimeve të lëshuara nga strukturat paralele. Ky vendim duhet bëhet publik kështu që individët të cilët mbështeten në strukturat paralele të dijnë me siguri se cilat të drejta dhe obligime juridike i posedojnë. Nëse këto vendime do të trajtohen si të vlefshme, atëherë edhe afatet dhe kohëzgjatja e tyre duhet të bëhet e qartë. Për shembull, OSBE sugjeron që 13 janari 2003 si datë përfundimtare deri në të cilën njihen vendimet e gjyktave paralele në komunat veriore duke u bazuar në atë se kjo është data kur janë hapur zyrtarisht gjykatat e UNMIK-ut në Zubin Potok dhe Leposavić/Leposaviq.

Për më tepër, UNMIK-u duhet të merrë parasyshë faktin se individët që kanë nevojë të udhëtojnë në Serbi, nuk mund ta bëjnë një gjë të tillë përveq nëse ata i paraqesin dokumentet

të cilat janë lëshuar nga autoritetet e Serbisë. Duhet të ndërpritet praktika e arrestimit dhe dënimit të njerëzve për shkak të posedimit të dokumenteve të rrejshme vetëm për shkak se thjeshtë janë lëshuar nga autoritetet serbe të cilat veprojnë në Kosovë. Gjyqtarët dhe prokurorët duhet të kenë parasyshë politikën e UNMIK-ut të parashikuar në Qarkoren e drejtësisë nr. 2003/1 dhe vendimin e fundit të Gjykatës Supreme mbi këto çështje. Zgjidhja më pragmatike për zgjidhjen e këtij problemi do të ishte që UNMIK-u të tolerojë të gjitha dokumentet serbe, pa marrë parasyshë vendin e lëshimit të tyre. Në të njëjtën kohë UNMIK-u duhet që ngadalë të zvogëlojë praninë e strukturave të papranuara serbe të administratës brenda territorit të Kosovës. Për çdo rast, UNMIK-u duhet të jetë më transparent dhe të informojë publikun për statusin e dokumentacionit serb.

Dokumenti i përbashkët<sup>84</sup> parashikon që serbët e Kosovës duhet të kenë qasje në arsimim në gjuhën e tyre, që nga shkolla fillore deri në universitet. IPV-es/Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë (MASHT) duhet të krijojë kushte në të gjitha shkollat e Kosovës që t'i përmbushin nevojat e të gjitha komuniteteve, përsëri edhe serbëve të Kosovës. Posaçërisht duhet të sigurohen librat dhe materiali mësimor në të gjitha gjuhët zyrtare në Kosovë. MASHT dhe Ministria e Arsimit dhe Sportit e Serbisë duhet që në mënyrë të ndërsjellë t'i pranojnë diplomat dhe qertifikatat e studentëve të tyre. Kur të punohet në këto çështje, autoritetet duhet t'i kushtojnë vëmendjen faktit se e drejta në arsim është e drejtë e fëmijës, dhe jo e drejtë prindërore.

Spitalet serbe ose objektet tjera shëndetësore janë dëshmuar si të domosdoshme për dhënjen e shërbimeve për disa komunitetet të cilat kanë frikë që t'i kërkojnë këto shërbime nga objektet shëndetësore të udhëhequra nga institucionet kosovare. IPV-es/Ministria e Shëndetësisë duhet të ndajë resurse dhe të ndërmerrë masa proaktive për të arritur deri te këto komunitete për t'ju ndihmuar atyre që të tejkalojnë frikën. Për më tepër, Ministria e Shëndetit duhet të konsultohet me Ministrinë serbe të Shëndetësisë nga aspekti i përmirësimit të shërbimit shëndetësor për të gjitha komunitetet në Kosovës dhe të integrojë personelin mjekësor serb të Kosovës në strukturat shëndetësore të Kosovës.

Çfarëdo masash dhe metodash që UNMIK-u duhet t'i përdorë për të zgjidhur problemin e strukturave paralele, duhet të përpiqet që mos t'i tjetërsojë (armiqësojë) strukturat, personat që punojnë me to ose të cilët kanë përfituar me mirëbesim nga to.

---

<sup>84</sup> UNMIK-FRJ Dokumenti i përbashkët, 5 nëntor, 2001, faqe 6.